



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 144

Tiranë – E martë, 4 gusht 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 86/2020 datë 9.7.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 24, datë 27.5.2020, “Për një shtesë në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19’, të ndryshuar”.....	9141
Ligj nr. 88/2020 datë 9.7.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 26, datë 10.6.2020, “Për marrjen e masave të përkohshme për mbështetjen e sektorit të turizmit”.....	9141
Vendim i Kuvendit nr. 48/2020, datë 27.7.2020	Për miratimin e raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor të Kuvendit, për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve dhe të procedurës së ndjekur nga Presidenti i Republikës, në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 84/2019.....	9141
Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2020	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2019.....	9142
Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2020	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2019.....	9143
Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2020	Për vlerësimin e punës së Departamentit të Administratës Publike (DAP) për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2019.....	9144
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 29.7.2020	Për lirim nga detyra.....	9146
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 601, datë 29.7.2020	Për lirim nga detyra.....	9146
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 29.7.2020	Për lirim nga detyra.....	9146

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 603, datë 29.7.2020	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	9146
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 29.7.2020	Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara.....	9147
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 29.7.2020	Për regjistrimin e pemëve dhe të pasurive natyrore.....	9172
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 606, datë 29.7.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, të ndryshuar.....	9173
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 607, datë 29.7.2020	Për tarifën për llojet e shërbimeve që ofrohen nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.....	9174
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 29.7.2020	Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19.....	9177
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 29.7.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....	9179
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 29.7.2020	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).....	9181
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 29.7.2020	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.....	9182
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 29.7.2020	Për një shtesë në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....	9182
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 29.7.2020	Për shembjen e katër objekteve të dhëna me qira, me kontratën e qirasë nr. 1998 rep., nr. 767 kol., datë 19.4.2019, me tarifën 1 euro/kontrata, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe fondacionit “Fundjavë ndryshe”, si qiramarrës, në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë.....	9183
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 29.7.2020	Për transferimin e pronësisë nga Autoriteti Rrugor Shqiptar te Bashkia Tiranë, të segmenteve rrugore dytësore, kthesa e Kamzës–Vorë (paralele djathtas) dhe kthesa e Kamzës–Vorë (paralele majtas).....	9184
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 29.7.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga e Arbrit” (shtesa).....	9184

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 29.7.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 718, datë 20.10.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Unaza e Madhe e Tiranës”.....	9188
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 619, datë 29.7.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i hapësirës së varrezave”, në fshatin Çermë e Sipërme, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë.....	9189
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 29.7.2020	Për përcaktimin e kushteve dhe të mënyrës së përfutimit të mbrojtjes së veçantë të garantuar nga shteti për përmbaruesin gjyqësor.....	9190
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 29.7.2020	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Helki Kamberi.....	9191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 622, datë 29.7.2020	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Theodhori Banushi.....	9192
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 29.7.2020	Për miratimin e paketës së programit të depistimit të kancerit të gjirit në Shqipëri.....	9192
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 624, datë 29.7.2020	Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.....	9193
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 29.7.2020	Për një shtesë në vendimin nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar.....	9198
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 626, datë 29.7.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 488, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit prej 950 295 959 lekësh, në programin ‘Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit’”.	9198
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 29.7.2020	Për miratimin e tarifës së biletave të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor.....	9200
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 29.7.2020	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe “Caritas Shqiptar”, për bashkëpunim në fushën e ndërtimit të banesave pas fatkeqësisë.....	9201
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 630, datë 29.7.2020	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqatës bamirëse “Jetimët e Ballkanit” për bashkëpunim në fushën e ndërtimit të banesave pas fatkeqësisë.....	9204
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 29.7.2020	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.....	9206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 637, datë 29.7.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ‘Tish Daia’ me rrugën ‘Robert Shvarc’, Tiranë.....	9208
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 153, date 30.7.2020	Për delegim të përkohshëm kompetencash.....	9211



LIGJ
Nr. 86/2020

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 24, DATË 27.5.2020, “PËR NJË SHITESË NË AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 24, datë 27.5.2020 “Për një shtesë në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19’, të ndryshuar”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020.

LIGJ
Nr. 88/2020

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 26, DATË 10.6.2020, “PËR MARRJEN E MASAVE TË PËRKOHSHME PËR MBËSHTETJEN E SEKTORIT TË TURIZMIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 26, datë 10.6.2020, “Për marrjen e masave të përkohshme për mbështetjen e sektorit të turizmit”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020.

VENDIM
Nr. 48/2020

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT, PËR TË KONTROLLUAR LIGJSHMËRINË E VEPRIMEVE TË KRYERA NGA ANA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË KUADËR TË USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE TË TIJ LIDHUR ME ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, SI DHE PËR TË KONTROLLUAR LIGJSHMËRINË E VEPRIMEVE DHE TË PROCEDURËS SË NDJEKUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS, NË KUADËR TË EMËRIMIT TË GJYQTARËVE KUSHTETUES, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 84/2019

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 78 të Kushtetutës; nenit 22, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionim e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor “Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë në kuadër të



ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve dhe procedurës së ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues” sipas teksti që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 27.7.2020

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE PËR VITIN 2019**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar kontributin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtëm të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje;

Duke njohur misionin e Autoritetit për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe efektiv, që ofron shërbime cilësore dhe promovon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në drejtëm të:

- Monitorimit të procesit të pagesave të prapambetura të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, me qëllim frenimin në të ardhmen të fenomenit të akumulimit të detyrimeve.

- Shtimit dhe rinovimit të platformave dhe aplikacioneve *online* në ndihmë të qytetarëve, si: verifikimi i policës TPL në faqen e internetit të AMF-së, akses në regjistrin e dëmeve për ndjekjen e ecurisë së trajtimit të dosjes së dëmit, si edhe hyrje në platformën *online* të ankesave.

- Ndërtimit dhe implementimit të Sistemit të Raportimit Financiar *online* për tregun e kapitaleve dhe të fondeve në bashkëpunim me operatorin dhe shoqëritë e fondeve.

- Miratimit për herë të parë të primit të rrezikut për MITPL-në e brendshme për çdo shoqëri sigurimi më vete.

- Ndërmarrjes së iniciativës për të filluar procesin e hartimit të një strategjie kombëtare me fokus edukimin financiar të publikut në bashkëpunim me institucionet e tjera në vend.

- Rritjes së numrit të inspektimeve tematike, në vend dhe në distancë, për aktivitetin aktual, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të lëna në inspektimet e mëparshme.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2020 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Të marrë masa konkrete për të reduktuar riskun e veprimtarisë në tregjet nën mbikëqyrje, që mund të shkaktohet nga rastet e fatkeqësive natyrore dhe shëndetësore, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e mirëfunksionimi i tregjeve, si dhe mbrojtja e personave të siguar dhe investitorëve.

- Të paraqesë për miratim në Kuvend draftin përfundimtar të projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe të hartohen aktet nënligjore të nevojshme pas miratimit të tij.

- Të kryejë periodikisht verifikimet nëpërmjet inspektimeve në shoqëritë e sigurimit dhe BSHS-së për dëmet objekt Fond Kompensimi. Të verifikojë saktësinë e të dhënave të raportuara dhe korrektësinë në kryerjen e pagesave. Të monitorojë, në veçanti, shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Të raportojë në Kuvend me bazë 4-mujore.

- Të vijojë punën për hartimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve përkatëse pas miratimit të ligjeve “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, “Për tregjet e kapitalit” dhe “Për shërbimet financiare bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, me qëllim implementimin e këtyre ligjeve në funksion të zhvillimit të tregjeve financiare dhe të ekonomisë së vendit në tërësi, por edhe në mbrojtje të investitorëve shqiptarë dhe integritetit të tregut.

- Të shikojë mundësinë për integrimin dhe ofrimin e disa shërbimeve për qytetarët përmes platformës *e-Albania*. Të vijojë me digjitalizimin, duke reduktuar përdorimin e letrave për të kaluar gradualisht në një regjim “Paperless” (Pa letra).

- Të ushtrojë funksion aktiv për uljen e numrit të të pasiguarve në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar operimin në të njëjta kushte të individëve dhe të bizneseve. Të bashkëpunojë me institucionet e tjera përgjegjëse për një fushatë sensibilizimi apo



strategji komunikimi dhe një plan veprimi për të ulur numrin e të pasiguarve në treg, aty ku sigurimi është detyrim ligjor.

- Të mbikëqyrë plotësimin e detyrimeve ligjore të kompanive që operojnë në tregjet e sigurimit. Të gjitha kompanitë duhet të përmbushin detyrimet ligjore të ushtrimit të veprimtarisë dhe marrjes së licencës, përfshirë edhe kriteret për plotësim të kapitalit minimal dhe të mbulimit të provigjoneve teknike.

- Të shtojë përpjekjet për zgjerimin dhe forcimin e tregjeve nën mbikëqyrje, sidomos të tregut të pensioneve private vullnetare, i cili është ende modest, duke shtuar fushatat sensibilizuese për njohjen e publikut me përfitimet e këtij tregu.

- Të rrisë kontributin e tij për zgjerimin e mbulimit të sigurimit të pronës si domosdoshmëri në rastet e fatkeqësive natyrore.

- Në funksion të transparencës dhe edukimit financiar, të përditësojë dhe pasurojë vazhdimisht informacionin në faqen zyrtare *online* të AMF-së rreth koncepteve, produkteve dhe rreziqeve financiare, për të rritur besueshmërinë e konsumatorëve në tregjet financiare, si dhe në rolin e Autoritetit në mbrojtje të interesave të tyre.

- Të forcojë kapacitetet mbikëqyrëse të Autoritetit me fokus përmirësimin e aftësive për menaxhimin e skenarëve të krizave të tregjeve nën mbikëqyrje.

- Të sigurohet që Byroja Shqiptare e Sigurimit të përditësojë faqen zyrtare *online* periodikisht me informacion të plotë dhe lehtësisht të kuptueshëm për konsumatorët.

KRYTAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 23.7.2020.

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
PËR VITIN 2019**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur misionin e INSTAT-it për prodhimin e statistikave asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve për proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit;

Duke marrë në konsideratë se INSTAT-i është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në vend dhe përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor;

Duke vlerësuar se statistikave zyrtare shpërndahen duke respektuar parimet statistikore të përcaktuara në ligj, duke mbrojtur konfidencialitetin statistikor dhe duke siguruar akses të barabartë për të gjithë përdoruesit;

Duke inkurajuar forcimin e bashkëpunimit të INSTAT-it me prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave zyrtare brenda dhe jashtë vendit, për të plotësuar nevojat e tyre me informacion cilësor e të përditësuar dhe për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera në rajon dhe Evropë;

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Statistikave gjatë vitit 2019 në drejtim të:

- Realizimit të të gjitha aktiviteteve të parashikuara sipas dokumentit strategjik dhe buxhetit të Censit dhe sidomos aktivitetit më të rëndësishëm të fazës përgatitore, Pilotit të Censit.

- Kontributit me dy aktivitete statistikore *ad-hoc* për të matur impaktin e dëmeve të tërmetit pranë familjeve dhe ndërmarrjeve në zonat më të prekura.

- Shtimit të prezencës në media lidhur me transmetimin e të dhënave të prodhuara dhe kuptueshmërinë e produkteve statistikore.

- Prodhimit të statistikave zyrtare në nivel vendor, për një njohje dhe kuptim më të mirë të të dhënave në secilën bashki e komunë të vendit.

- Rritjes së bashkëpunimit me botën akademike përmes shkëmbimit të praktikave, bashkëpunimit për përgatitjen e artikujve shkencorë dhe sigurimit të aksesit në të dhënat mikro për qëllime shkencore.

- Ngritjes së grupit ndërinstucional të punës për integrimin evropian dhe angazhimit për furnizimin me informacionin e duhur statistikor të të gjithë kapitujve të tjerë të *acquis*.

Kuvendi rekomandon që Instituti i Statistikave për vitin 2020 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Të ketë transparencë të plotë të kontributit që jep Këshilli i Statistikave në INSTAT, në përmbushje të detyrimeve që i ngarkon ligji nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare”. Të publikohen raportet e rekomandimeve të lëna nga Këshilli i Statistikave dhe aktet e miratuara nga bordi drejtues, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.



Të publikohet pjesëmarrja e anëtarëve në çdo mbledhje dhe mënyra sesi ka votuar secili anëtar.

- Të plotësojë sa më parë vendet vakante në pozicionet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, për të garantuar menaxhimin e nëpunësve civilë sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

- Të marrë masa konkrete për të reduktuar riskun e veprimtarisë statistikore, që mund të shkaktohet nga rastet e fatkeqësive natyrore, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e proceseve. Masat e marra të paraqiten në planin vjetor të INSTAT-it.

- Të fuqizojë kapacitetet e teknologjisë së informacionit, si në infrastrukturë, ashtu edhe në staf të kualifikuar për përpunim modern të dhënash dhe prodhim statistikash cilësore.

- Të vazhdojë punën për përmirësimin e pyetësorit të Censit, si edhe materialeve të tjera shoqëruese, bazuar në gjetjet e Pilot Censit të kryer në vitin 2019, si dhe të përditësojë zonat në terren pas situatave të krijuara nga emergjencat e fundit që kanë ndodhur në vend.

- Të hartojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Censin e Bujqësisë 2022.

- Të harmonizojë Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor me formatin e strategjive të tjera kombëtare dhe sektoriale për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar, IPSIS, përfshirë edhe hartimin e planit strategjik për përafrimin me *acquis* në fushën e statistikave, duke marrë në konsideratë edhe prioritetet e vendosura nga BE-ja në procesin e çeljes së negociatave me Shqipërinë.

- Të finalizojë ngritjen e Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare, i cili është një mekanizëm i rëndësishëm për cilësinë e proceseve të planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore.

- Të punojë për t’iu përafruar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare, nëpërmjet rritjes së edukimit statistikor dhe organizimit të takimeve formale e informale me përfaqësuesit e medias.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.7.2020.

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË
DEPARTAMENTIT TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE (DAP)
PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL
PËR VITIN 2019**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e DAP-it, si njësi përgjegjëse në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore në shërbimin civil, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;

Duke mbështetur DAP-in për zhvillimin e mëtejshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë;

Duke konsideruar përparësinë e zhvillimit të mëtejshëm të reformës së administratës publike si një prioritet kyç për hapjen e negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian,

vlerëson veprimtarinë e Departamentit të Administratës Publike për vitin 2019 në drejtim të:

- Zhvillimit të mëtejshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë, duke shënuar një rritje cilësore të procesit të rekrutimit, duke arritur nga viti në vit jo vetëm rritje të numrit të aplikimeve për të gjitha pozicionet e shpallura, por edhe rritje të përqindjes së kandidatëve të kualifikuar dhe rritje të numrit mesatar të aplikantëve/pozicion pune.

- Punësimit të përkohshëm për një periudhë 1-vjeçare të studentëve të ekselencës, ku për vitin 2019 rezulton të jenë bërë 1900 aplikime dhe më pas të jenë emëruar në shërbimin civil dhe me Kod Pune 602 studentë.

- Zbatimit dhe monitorimit të Planit të Veprimit 2018–2022 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike nëpërmjet realizimit të pjesës më të madhe të nënaktiviteteve që ka plani.

- Aftësimin të mëtejshëm të administratës, ku nëpërmjet mbështetjes së organizmave ndërkombëtarë, si: Bashkimi Evropian apo Këshilli i Evropës, u arrit trajnimi i punonjësve të linjës së parë të shërbimit *Front-Office* për temën *Soft Skills*, si dhe i menaxherëve për temën e *Leadership*-it.



- Përmirësimin të ndërveprimit mes institucioneve publike dhe qytetarëve nga përdorimi i platformës administrata.al, nëpërmjet së cilës është arritur të sigurohet raportimi i informacionit në kohë reale, unifikimi i praktikave administrative, si dhe mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore.

- Rishikimin të strukturave dhe organikave të institucioneve shtetërore, për një organizim më të mirë të punës dhe rialokim më të mirë të burimeve njerëzore, duke realizuar ristrukturimin e 54 institucioneve, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe disa agjenci të lidhura me turizmin dhe mjedisin.

- Hartimin të draftdokumentit për reformimin e sistemit të pagave të nëpunësve civilë dhe përcaktimin e disa standardeve për pagat e nëpunësve të administratës publike në tërësi, i cili është diskutuar më pas në disa tryeza konsultimesh me ekspertë të lartë të fushës.

- Vënies në funksionim të instrumenteve të teknologjisë së informacionit për të përmirësuar ndjeshëm procesin e administrimit të dokumentacionit, për sa u takon zbatimin të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nëpërmjet raportimit *online* në portalin administrata.al.

- Bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë, si dhe me përfaqësues të botës akademike, me qëllim sigurimin e kandidatëve më të mirë nga radhët e studentëve dhe të sapodiplomuarve.

- Administrimit dhe përpunimit të 2182 formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor, që nuk përfshihen në shërbimin civil, si dhe konstatimit të 20 rasteve kur subjektet vetëdeklaruese rezultojnë në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik.

- Shtirjes së mëtejshme të sistemit HRMIS gjatë vitit 2019, duke e çuar numrin e institucioneve të administratës publike që përdorin sistemin në 920 dhe ku mund të sigurohet informacion për mbi 60240 të punësuar.

Kuvendi kërkon që Departamenti i Administratës Publike për vitin 2020 të angazhohet në këto drejtime:

- Të krijohet kushtet për të rritur pjesëmarrjen në proceset e rekrutimit të kandidatëve me nivel të lartë përgatitjeje dhe të menaxhohet procesi në

drejtim të zvogëlimit të numrit të konkurrimeve, duke realizuar një ndarje sa më efektive të grupeve, në të cilat të përfshihen pozicione me specifika të njëjta, si dhe të krijohen kushtet për të siguruar transparencën e nevojshme dhe vlerësimin objektiv të kandidatëve që marrin pjesë në konkurrim.

- Të vijojë punën për rritjen e cilësisë së trupës së nëpunësve civilë të rekrutuar nëpërmjet ndërveprimit me qytetarët, për të rritur numrin e konkurrentëve, duke publikuar në portalin *online* të aplikimit informacione që shërbejnë për të kuptuar procedurat e rekrutimit dhe për t'i ndërgjegjësuar ata për rëndësinë e rritjes së nivelit të pjesëmarrjes në këto procedura, si dhe shembuj të praktikave të mira të konstatuara në këtë drejtim.

- Të intensifikojë punën për rishikimin e përshkrimeve të punës dhe për rishikimin e metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës.

- Të miratojë bazën ligjore për funksionimin e portalit administrata.al dhe vënien në funksion të tij, me qëllim zbatimin e unifikuar të procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil.

- Brenda gjashtëmuorit të parë të vitit 2021 të përmbyllë punën për konsultimin e dokumentit për reformën e pagave, evidentimin e efekteve financiare dhe planifikimin e hapave në vijim për implementimin e kësaj reforme. Të përshtatë pagat në varësi edhe të angazhimeve dhe të detyrave që nëpunësit përmbushin, si rrjedhojë e detyrimeve të ligjeve të veçanta, siç është edhe ligji nr.60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

- Të luajë një rol aktiv mbikëqyrës në kushtet kur administron Regjistrin Qendror të Personelit, për rastet e përfundimit të marrëdhënies me shërbimin civil, për shkak të plotësimin të moshës për pension të plotë pleqërie, për të siguruar informacion të përditësuar të situatës në shërbimin civil në administratën shtetërore.

Kuvendi kërkon që Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, për vitin 2020, të angazhohet në këto drejtime:

- Të ndërmarrë hapat e nevojshëm për rritjen e trajnimeve për nëpunësit civilë të nivelit lokal.



- Të përditësojë në mënyrë të vazhdueshme databazat me personat e trajnuar, në mënyrë që informacioni për ta të jetë sa më koherent.

- Të hartojë dhe të miratojë objektivat e kënaqësisë së klientit për kurset e trajnimit, sipas kërkesave të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2018–2022.

- Të marrë masa për të kryer vlerësime periodike të pavarura të cilësisë së shërbimit çdo dy vjet, sipas kërkesave të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2018–2022.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 23.7.2020.

VENDIM
Nr. 600, datë 29.7.2020

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Dorina Çinari, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 601, datë 29.7.2020

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Fjoralba Caka, zëvendësministër i Drejtësisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 602, datë 29.7.2020

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Rovenë Voda, zëvendësministër i Brendshëm, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 603, datë 29.7.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-



së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT, SIPAS
REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË
SIGURIMIT TË OKB-SË
(LISTA E OKB-së)**

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE
BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT
ISIL (DA’ESH) DHE AL-QAIDA”:

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”:

Noor Wali Mehsud

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

**VENDIM
Nr. 604, datë 29.7.2020**

**PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA
NDËRTIMET E LEGALIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet e legalizuara në drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës: Vlorë, Tiranë Veri, Shkodër, Tiranë Jug, Lushnjë, Kamzë-Vorë, Elbasan, Kukës, Kavajë, Tiranë Rurale 1, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Fier, Sarandë, Zonat e Stimuluara.

2. Masa e kompensimit është 53 352,11 (pesëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e dy presje njëmbëdhjetë) m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 523 818 616,47 (pesëqind e njëzet e tre milionë e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë presje dyzet e shtatë) lekë, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Për kompensimin financiar, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Për pronat me numrat rendorë sipas kolonës 13, të shtojcës nr. 1, përkatësisht, nr. 12, nr. 30, nr. 32, nr. 51, nr. 52, nr. 53, nr. 56, nr. 59, nr. 61, nr. 62, nr. 66, nr. 67, nr. 72, nr. 76, nr. 77, nr. 84, nr. 86, nr. 88, nr. 90, nr. 91, nr. 129, nr. 162, nr. 172, nr. 173, nr. 174, nr. 193, nr. 194, nr. 197, nr. 209, nr. 213, nr. 214, nr. 223, nr. 224, nr. 228, nr. 229 sipas seksionit të veçantë (kolona 17), shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, sipas pikës 3, të



nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

b) Për pronat me numrat rendorë sipas kolonës 13, të shtojcës nr. 1, përkatësisht nr. 3, nr. 5, nr. 15, nr. 35, nr. 46, nr. 63, nr. 89, nr. 143, nr. 159, nr. 160, nr. 215 sipas seksionit të veçantë (kolona 17), shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, pa përfunduar procedura e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

4. Për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore edhe për

pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen.

5. Drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës: Vlorë, Tiranë Veri, Shkodër, Tiranë Jug, Lushnjë, Kamzë-Vorë, Elbasan, Kukës, Kavajë, Tiranë Rurale 1, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Fier, Sarandë, Zonat e Stimuluara të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri, në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

6. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Shtojca 1

 AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS
 LISTA EMËRORE E SUBIEKTEVE OË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE TË KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPËRBLIMIT

Të dhënat e pasurisë së legalizuar					Gjendja juridike (pronësia)	Pjesa takues e në parcelë (m ²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²)	Numri i pronarëve që kompensohen	Kompensimi i pronarëve									
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit						Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i veçantë	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	
VLORE																		
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8602																		
1	ANDREA	NANO	ÇAKALLI	212253	10.26.2018	Shtetërore (0) m ² E të tretëve (307) m ²			1	AGIM		BEDINI	1	38/40	266.00	10.903	2,900,198.00	
									2	BASHKIM		BEDINI						
									3	BEDIN		BEDINI						
									4	BENJAMIN		BEDINI						
									5	BULE		BEDINI (QATIP)						
									6	DURIM		BEDINI						
									7	EMLIHA		BEDINI						
									8	FATMIR		BEDINI						
									9	GJINOVEFA		BEDINI						
									10	JETA		BEDINI						
									11	LAVDOSH		BEDINI						
									12	LEMA		BEDINI (BESHO)						
									13	LENIE		BEDINI (KRESHPA)						
									14	LILJANA		BEDINI						
									15	LIRIM		BEDINI						
									16	LONDON		BEDINI						
									17	LUAN		BEDINI						
									18	MARIKA		BEDINI (KURTI)						
									19	NESKE		BEDINI						
									20	NEXHIP		BEDINI						
									21	NJAZI		BEDINI						
									22	REFIJE		BEDINI						
									23	SHPETIM		BEDINI						
									24	VALTER		BEDINI						
									25	VIOLETA		BEDINI (BEREQ)						
									26	ZHANE TA		BEDINI (XHYERI)						
									27	NAFIZE		KAPLLANI						
2	KRENAR DASHAMIR	RUSTEM RUSTEM	KOÇIRAJ KOÇIRAJ	29560	23.8.2012	Shtetërore (56) m ² E të tretëve (244) m ²			29	AGIM		BEDINI	4	38/60	91.00	10.903	992,173.00	
									30	BASHKIM		BEDINI						
									31	BEDIN		BEDINI						
									32	BENJAMIN		BEDINI						
									33	BULE		BEDINI (QATIP)						
									34	DURIM		BEDINI						
									35	EMLIHA		BEDINI						
									36	FATMIR		BEDINI						
									37	GJINOVEFA		BEDINI						
									38	JETA		BEDINI						
									39	LAVDOSH		BEDINI						
									40	LEMA		BEDINI (BESHO)						
									41	LENIE		BEDINI (KRESHPA)						
									42	LILJANA		BEDINI						
									43	LIRIM		BEDINI						
									44	LONDON		BEDINI						
									45	LUAN		BEDINI						
									46	MARIKA		BEDINI (KURTI)						
									47	NESKE		BEDINI						
									48	NEXHIP		BEDINI						
									49	NJAZI		BEDINI						
									50	REFIJE		BEDINI						
									51	SHPETIM		BEDINI						
									52	VALTER		BEDINI						
									53	VIOLETA		BEDINI (BEREQ)						



						54	ZHANETA	BEDINI (XHYERI)						Arsyet e kufizimit: 1.VKKP nr. 397, datë 11.11.2008, pronarët Pappallo (dokumentacioni ndodhet në ref. 013524). 2.VKKP nr. 359, datë 5.6.2003 në pronësi të SHISH-it, i regjistruar në nr. hipotekor 13, datë 9.6.2006 (dok. ndodhet në ref. 014846).		
						55	MBIVENDOSJE (urdhër kufizimi nr. 13001, datë 17.9.2013)		5	38/57	153.00	10.903	1,668,159.00			
3	RIZA	MEMISHA	SHKURTAJ	213050	31.7.2019	Shtetërore (0) m ² E të tretëve (428) m ²	56	AGIM	BEDINI	6	38/165	352	10903	3,837,856.00		
							57	BASHKIM	BEDINI							
							58	BEDIN	BEDINI							
							59	BENJAMIN	BEDINI							
							60	BULE	BEDINI (QATIP)							
							61	DURIM	BEDINI							
							62	EMLIHA	BEDINI							
							63	FATMIR	BEDINI							
							64	GJINOVEFA	BEDINI							
							65	JETA	BEDINI							
							66	LAVDOSH	BEDINI							
							67	LEMA	BEDINI (BESHO)							
							68	LENIE	BEDINI (KRESHPA)							
							69	LILJANA	BEDINI							
70	LIRIM	BEDINI														
71	LONDON	BEDINI														
72	LUAN	BEDINI														
73	MARIKA	BEDINI (KURTI)														
74	NESKE	BEDINI														
75	NEXHIP	BEDINI														
76	NJAZI	BEDINI														
77	REFIJE	BEDINI														
78	SHPETIM	BEDINI														
79	VALTER	BEDINI														
80	VIOLETA	BEDINI (BEREQ)														
81	ZHANETA	BEDINI (XHYERI)														
82	AGIM	BEDINI														
83	BASHKIM	BEDINI														
84	BEDIN	BEDINI														
85	BENJAMIN	BEDINI														
86	BULE	BEDINI (QATIP)														
87	DURIM	BEDINI														
88	EMLIHA	BEDINI														
89	FATMIR	BEDINI														
90	GJINOVEFA	BEDINI														
91	JETA	BEDINI														
92	LAVDOSH	BEDINI														
93	LEMA	BEDINI (BESHO)														
94	LENIE	BEDINI (KRESHPA)														
95	LILJANA	BEDINI														
96	LIRIM	BEDINI														
97	LONDON	BEDINI														
98	LUAN	BEDINI														
99	MARIKA	BEDINI (KURTI)														
100	NESKE	BEDINI														
101	NEXHIP	BEDINI														
102	NJAZI	BEDINI														
103	REFIJE	BEDINI														
104	SHPETIM	BEDINI														
105	VALTER	BEDINI														
106	VIOLETA	BEDINI (BEREQ)														
107	ZHANETA	BEDINI (XHYERI)														
4	KRENAR, AGIM	XHELAL, XHELAL	BINOZI, BINOZI	211175	7.19.2018	Shtetërore (446) m ² E të tretëve (54) m ²	85	BENJAMIN	BEDINI	7	38/59	76	10903	828,628.00		
							86	BULE	BEDINI (QATIP)							
							87	DURIM	BEDINI							
							88	EMLIHA	BEDINI							
							89	FATMIR	BEDINI							
							90	GJINOVEFA	BEDINI							
							91	JETA	BEDINI							
							92	LAVDOSH	BEDINI							
							93	LEMA	BEDINI (BESHO)							
							94	LENIE	BEDINI (KRESHPA)							
							95	LILJANA	BEDINI							
							96	LIRIM	BEDINI							
							97	LONDON	BEDINI							
							98	LUAN	BEDINI							
99	MARIKA	BEDINI (KURTI)														
100	NESKE	BEDINI														
101	NEXHIP	BEDINI														
102	NJAZI	BEDINI														
103	REFIJE	BEDINI														
104	SHPETIM	BEDINI														
105	VALTER	BEDINI														
106	VIOLETA	BEDINI (BEREQ)														
107	ZHANETA	BEDINI (XHYERI)														
5	BAJRAM	SHEREB	ÇELAJ	108058	19.5.2017	Shtetërore (0) m ² E të tretëve (337) m ²	108	ANDI	MUSTA	8	9/206	337	10903	3,674,311.00		
							109	ORJOLA	SHEHU							
							110	SADETE	MUSTA (BYLYSHI)							
							111	ANGJELINA	MUSTA (DALIPAJ)							
							112	ANEST	MUSTA							
							113	SHPEND	MUSTA							
							114	VLADIMIR	MUSTA							
							115	ILIAS	MUSTA							
							116	ARJAN	MUHAREM							BRAHIMI
							117	MUHAREM	SELIM							BRAHIMI
							118	LILJANA								MUSTA
119	ALKET	MUHAREM	BRAHIMI													

QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8602

QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8603



6	BUJAR	NEKI	MYRTAJ	210085	11.24.2017	Shtetërore (2) m ² E të tretëve (259) m ²			120	MEDIN	SINAJ	9	25/233	250	10903	2,725,750.00	
									121	TATJANA	SINAJ	10	25/232	2		21,806.00	
									122	HYRIE	HOXHA	11	25/220	7		76,321.00	
									123	MALIA	HOXHA						
									124	SEZAI	HOXHA						
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8602																	
7	LEFTER	JANI	KURETA	212699	2.22.2019	Shtetërore (0) m ² E të tretëve (135) m ²			125	SERVET	SHAHINI	12	14/299/2	135.00	10,903	1,471,905.00	Nr. dok 9585, datë 17.12.2009. Kontratë sipërmarrjeje e bërë midis firmës "Agni" dhe pronarëve, nr. dok. 9898, datë 6.6.2010, akt transferimi i veprimtarisë ekonomike "Lorena" dhe "Agni" sh.p.k.
									126	RAMIZ	SHAHINI						
8	LEFTER	JANI	KURETA	212695	2.21.2019	Shtetërore (0) m ² E të tretëve (288) m ²			127	BEJE	SHAHINI	13	9/206	267.00	10,903	2,911,101.00	
									128	SHERIFE	SHAHINI						
9	EQEREM	MELEQ	HEQIMAJ	30719	10.31.2012	Shtetërore (0) m ² E të tretëve (267) m ²			129	MYFTAR	SHAHINI	13	9/206	267.00	10,903	2,911,101.00	
									130	HYSTI	SHAHINI						
									131	HANI	SHAHINI						
									132	ANDI	MUSTA						
									133	ORJOLA	SHEHU						
									134	SADETE	MUSTA (BYLYSHI)						
									135	ANGJELINA	MUSTA (DALIPAJ)						
									136	ANEST	MUSTA						
									137	SHPEND	MUSTA						
									138	VLADIMIR	MUSTA						
									139	ILIAS	MUSTA						
									140	ARJAN	MUHAREM BRAHIMI						
									141	MUHAREM	SELIM BRAHIMI						
142	ALKET	MUHAREM BRAHIMI															
143	LILJANA	MUSTA															
10	PELLUMB	MUÇO	GJOMBRATI	210957	5.31.2018	Shtetërore (21) m ² E të tretëve (315) m ²			144	BESNIK	BALILI	14	8/34-T	315	10,903	3,434,445.00	
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8602																	
11	BUDJON	SELAMI	JANUSHAJ	107623	4.18.2017	Shtetërore (0) m ² E të tretëve (315.1) m ²			145	FETANET	HOXHA	15	45/113	315.1	10903	3,435,535.30	Për këtë pasuri ka dhe një titull tjetër të paraqitur për regjistrim vendim gjyqësor nr. 593, datë 11.3.2013, ref. 016117
									146	HYSNIJE	MINARROLLI						
									147	RRAPUSH	HOXHA						
									148	ZYMBYLE	ARAPI						
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8604																	
12	BASHKIM	MUFIT	QAMILI	210781	5.21.2018	Shtetërore (0) m ² E të tretëve (20.5) m ²			149	ARTUR	MEZANI	16	24/74	20.5	6899	141,429.50	
TIRANË VERI																	
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8330, TIRANË																	
13	PETRIT	RIZA	QEMALLI	10502	7.5.2012	Shtet + Të tretëve			150	ARBEN	RRELI	17	5/731	39	34,068	1,328,652.00	
									151	ARIF	RRELI						
									152	BUJAR	RRELI						
									153	EDIT	RRELI						
									154	EVIS	EREBARA						
									155	GJYLE	RRELI						
									156	HASAN	RRELI						
									157	IBRAHIM	RRELI						
									158	LAVDIJE	RRELI						
									159	LILI	RRELI						
									160	MALIQ	RRELI						
									161	MET	RRELI						
									162	SEMIHA	RRELI (SOKOLI)						
									163	SHYQYRI	RRELI						
164	GANI	HASAN GASHI															
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8310, ZVRRPP TIRANË																	
14	JURGEN	BAJRAM	MULIU	90119	18.4.2016	Të tretëve			165	FITNET	XHELO	19	4/578	500.00	31,219	15,609,500.00	
									166	MIMOZA	SHEFOET						
									167	FATOS	ZEQIR						
									168	ROZANA	IRFAN						
									169	BUKURIE	IRFAN						
									170	EVA	PETRIT						
									171	MANJOLA	SELIM						
									172	LINDITA	SHEFOET						
									173	MIRVIJENA	SELIM						
									174	ENIS	BAJRAM						
									175	ELMA	BAJRAM						
									176	VJOLLCA	BEQIR						
									177	AGIM	IRFAN						
									178	REBEKA	IRFAN						
									179	SULEJMAN	ZEQIR						
									180	GERT	PETRIT						
									181	ARJAN	QEMAL						
									182	XHELADIN	QEMAL						
183	AIDA	QEMAL															
184	FIQIRETE	HAXHI															



											QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 2679						
15	ARDIAN	MISIR	GRECA	996777	27.02.2017	TË tretëve			185	LEONARD		SEJDINI	20	440/437	334.9	4,242	1,420,645.80
									186	HAJDIJE		TOPALLI					
									187	BUJAR		SEJDINI					
									188	ZYRA	SELMAN	AHMETAJ					
									189	SKENDER		SEJDINI					
									190	SINAN	SELMAN	SEJDINI					
									191	QAMILE	TUG	SEJDINI					
									192	LULJETA	HIDER	SEJDINI					
									193	BILAL	FADIL	SEJDINI					
									194	FATIME	FADIL	SHIMA					
									195	MAJLINDA	FADIL	BUSHI					
									196	LUMTURI	FADIL	MINELLI					
									197	QEMAL	SELMAN	SEJDINI					
									198	XHEVDET	SELMAN	SEJDINI					
199	ALI	SELMAN	SEJDINI														
200	GEZIM	SELMAN	SEJDINI														
201	ENKELEJDA	AGIM	SEJDINI														
202	FLORA	HIDER	JUPAS														
203	DRITA	AGIM	SEJDINI														
											QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8330						
16	SHAQIR	HILMI	KECO	1231773	20.12.2019	Të vet + shtet+ të tretëve			204	ALI		SKIFTERI	21	3/438	82.9	34,068	2,824,237.20
									205	BAHRI		SKIFTERI					
									206	BASHKIM		SKIFTERI					
									207	ELISABETA		SKIFTERI					
									208	ELMA		SKIFTERI					
									209	ERVIS		SKIFTERI					
									210	GANI		SKIFTERI					
									211	GENTIANA		SKIFTERI					
									212	HAVA		SKIFTERI					
									213	ARJAN		BEKA					
214	IRENA		BEKA														
215	ROVENA		KOVACI														
216	SERVETE		BEKA														
											QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8130						
17	BASHKIM	BAFTJAR	XHUTI	1232385	29.4.2020	Shtet + të tretëve			217	LEONARD	BAFTJAR	XHUTI	23	4/93	117	30,196	3,532,932.00
	ARBEN	XHELAL	HOXHA														
	GEZIM	DEMIR	ÇELAJ														
	IKBALE	QAMIL	ÇELAJ														
	MIRANDA	DEMIR	XHUTI														
	LINDITA	DEMIR	HOXHA														
											QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 3866						
18	FATOS	ENVER	RAMA	21528	15.11.2012	Të tretëve			218	SELMAN	SULEJMAN	DUMI	24	315/177	66.7	4,242	282,941.40
									219	BARDHYL	SYRJA	KARALLIU	25	315/64	223.7	4,242	948,935.40
											QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 2605						
19	MEVLAN	XHEMAL	SHAHINI	997472	19.5.2017	Të tretëve			220	QEMAL	KADRI	TOTA	26	414/94	500	2,560	1,280,000.00
									221	ASLLAN	KADRI	TOTA					
									222	KORAB	KADRI	TOTA					
											QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 2460						
20	SINAN	SEIT	KAZANI	123451	30.5.2018	Të tretëve			223	SHKELQIM	QAZIM	ISUFI	27	496/67/4 6	337.5	2,080	702,000.00
											QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8330						
21	ASLLAN	SALI	KALOSHI	122206	28.3.2018	Shtet + të tretëve			224	FLORINDA	AZIZ	HOXHA	28	1/348	266.7	34,068	9,085,936
									225	MAJLINDA	AZIZ	HOXHA					
									226	ALBANA	AZIZ	HOXHA					
											QARKU TIRANË ZONA KADASTRALE 8130						
22	NIKOLIN	NDOC	PACI	1231539	24.10.2019	Shtet+ të tretëve			227	BEDRI	HYSEN	TURKU	29	3/283	13.49	30,196	407,344.04
									228	FATBARDHA	HYSEN	TURKU					
									229	IBRAHIM	HYSEN	TURKU					
									230	LIRIE	HYSEN	TURKU					
									231	SEZAI	HYSEN	TURKU					
											QARKU TIRANË ZONA KADASTRALE 8330						
23	MARINGLEN	RAMAZAN	VULKA	1231269	28.6.2019	E të tretëve			232	HAKI		MEMA	30	1/333	29.3	34068	998192.4
									233	IGLI		SPAHUJA					
									234	MAJLINDA		HOXHA					
									235	FLORINDA		HOXHA					
									236	ALBANA		HOXHA					
									237	JUSUF		KOPRATA					
									238	ADRIATIK		KOPRATA					
									239	MAKSIM		KOPRATA					
									240	FATMIRA		KOPRATA					
									241	BEATRICE		KOPRATA					
									242	BARDHYL		MEMA					
									243	AGIM		MURATAJ					
									244	FIQIRETE		MEMA					
									245	DHURATA		MEMA					



									246	SKENDER		MEMA							
									247	ILIRJAN		MEMA							
									249	SUZANA		MEMA							
									250	DRITA		MEMA							
									251	BRUNILDA		MEMA							
									252	KLITON		MEMA							
									253	ENXHI		MEMA							
									254	LUNETI		MEMA							
24	ZENI	BAJRAM	KUSHE	15152	4.8.2014	Të tretëve			255	SADIK	FEJZULLA	XHAFA	31	45/64	173	3.413	590,449	QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 3292	
																		QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 8340	
25	MYFTAR	HAJREDIN	MUSTAFA	721144	23.10.2015	Të tretëve			256	AIDA		KASHARAJ	32	9/1177	285	30,158	8,595,030	KONTRATË SIPËRMARRJEJE "SHOGERIA METAL - CONS", NE FAVOR TË SHOQËRISE "METAL - CONS 2014" SHPK	
									257	ARBEN		PETRELA							
									258	SHEFKI	MALIQ	PETRELA							
2. Regjistrimi i pasurive natyrore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet kryesisht nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim “ASHK”) gjatë procedurës së regjistrimit fillestar dhe përmirësimit/përditësimit apo me aplikim të pronarit/ përfaqësuesit të autorizuar.

3. Për pasuritë e llojit pemë regjistrimi, në çdo rast, bëhet vetëm me kërkesë të pronarit (shtet apo privat) të pasurisë ku gjenden pemët.

II. PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI PËR REGJISTRIMIN E PEMËVE

4. Në kategorinë e pemëve që regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme hyjnë të gjithë

drurët që ndodhen brenda kufirit të pasurisë (tokës), pavarësisht llojit dhe pronësisë së pasurisë (nëse është private apo shtetërore).

5. Kërkesa për regjistrimin e pemëve nga subjekti i interesuar duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) listën e detajuar të inventarit të pemëve;

b) planin e rievimit (paraqitja grafike e pronës dhe pemëve), sipas modelit të miratuar;

c) aktin e fitimit të pronësisë, nëse nuk është regjistruar më parë.

6. Për regjistrimin e pemëve në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, drejtoria vendore e ASHK-së verifikon këto elemente:

a) legjitimitimin e subjektit, nëse ai është është pronari/bashkëpronari i pasurisë së paluajtshme mbi të cilën do të regjistrohen pemët apo përfaqësuesi i autorizuar i tij;

b) nëse dokumentacioni i depozituar për regjistrimin e pemëve është i plotë, sipas përcaktimeve të pikës 5, të këtij vendimi.

7. Kur pas kryerjes së verifikimeve, kërkesa për regjistrimin e pemëve i përmbush kushtet e përcaktura në lidhje me dokumentacionin dhe legjitimitimin e subjektit, sipas pikës 6, të këtij vendimi, vijohet me regjistrimin në kartelën e pasurisë së paluajtshme, sipas të dhënave të paraqitura në dokumentacionin tekniko-ligjor të depozituar për regjistrim, në përputhje me përcaktimet e nenit 29, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

8. Për pemët, regjistrimi kryhet duke pasqyruar numrin total të tyre, në rubrikën përkatëse të kartelës së pasurisë së paluajtshme.

9. Ndryshimi i numrit të pemëve, sipas gjendjes faktike nga momenti i regjistrimit, bëhet sipas akteve të miratuara nga organet kompetente dhe reflektohet në kartelën e pasurisë së paluajtshme, me kërkesën e pronarit apo personave të tjerë të autorizuar prej tij.

10. Pas regjistrimit të pemëve në regjistrat kadastralë, drejtoria vendore e ASHK-së pajis pronarin me kartelën e pasurisë, si dhe me sasinë e nevojshme të matrikujve për çdo pemë të regjistruar.

11. Matrikujt janë tabelat ku pasqyrohen numrat rendorë të pemëve dhe që vendosen nga pronari në çdo pemë. Pronari që ka kërkuar regjistrimin e pemëve është i detyruar të pasqyrojë numrat rendorë identifikues të pemës në secilën tabelë.



12. Modeli i matrikullit përcaktohet nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së. Matrikujt blihen nga ASHK-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe i vendosen në dispozicion pronarit.

III. PASQYRIMI I PASURIVE NATYRORE NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJT-SHME

13. Informacioni për pasuritë natyrore pasqyrohet në kartelën e pasurisë së paluajtshme, në rubrikën “lloji i pasurisë”, në seksionin “A” të saj. Në rastin e maleve, për efekt regjistrimi, lloji i pasurisë “mal” shënohet vetëm në kartelat e atyre sipërfaqeve të shpateve ose të majave të maleve, që nuk janë trajtuar ose inventarizuar, me dokumentacion ligjor si lloje të tjera pasurie.

14. Kur pasuria natyrore shtrihet në më shumë se një zonë kadastrale ajo pasqyrohet në kartela pasurie më vete, sipas secilës zonë, për pjesën përkatëse të sipërfaqes së pasurisë natyrore.

15. Në rastet e parashikuara në pikën 14, të këtij vendimi, numërtimi i pasurisë do të kryhet sipas rregullit bazë të vendosjes së numrit të pasurisë në një zonë kadastrale, duke bërë shënimin në kartelën e pasurisë për lidhjen e pasurisë natyrore midis zonave kadastrale kufitare.

16. Pasqyrimi në hartën kadastrale i pasurive natyrore, si: lumenj, liqene, male, basene, miniera, puse naftë, si dhe çdo pasuri tjetër natyrore, në përputhje me përcaktimet e nenit 142, të Kodit Civil dhe të nenit 62, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, kryhet sipas shenjave konvencionale përkatëse, të cilat ndryshojnë në varësi të shkallës së paraqitjes së hartës. Shenjat konvencionale të pasurive natyrore miratohen me udhëzim të përbashkët të drejtorit të përgjithshëm të ASHK-së dhe drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

17. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM Nr. 606, datë 29.7.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 893, DATË 4.11.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar; të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun II, të vendimit nr. 893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, pas shkronjës “i” shtohet shkronja “j”, me këtë përmbajtje:

“j) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Gjirokastër.”.

b) Shkronjat “d” dhe “dh” shfuqizohen.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM
Nr. 607, datë 29.7.2020

PËR TARIFAT PËR LLOJET E SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA SHËRBIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 36, të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozim të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat për llojet e shërbimeve në favor të shtetasve, subjekteve, fizike dhe juridike, që ofrohen nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, janë sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tarifat e përcaktuara në këtë vendim nuk aplikohen në raste të emergjencave civile dhe ngjarjeve të ndryshme aksidentale.

3. Të ardhurat që realizohen nga arkëtimi i pagesës së këtyre tarifave derdhen në nivel vendor për llogari të bashkisë përkatëse dhe në nivel qendror për llogari të Ministrisë së Brendshme. Këto të ardhura përdoren vetëm për financimin e veprimtarisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, për kompletimin me automjete, pajisje të ndryshme zjarrfikëse, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe rritjen e gatishmërisë së shërbimit zjarrfikës.

4. Vendimi nr. 285, datë 27.6.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për tarifën e shërbimeve që kryen nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ndaj shtetasve e personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Shtojca nr. 1

1. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri për objekte të destinuara për banim

1.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi deri në 12 metër, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë.

1.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 12 deri në 24 metër, tarifa është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë

1.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 24 deri në 32 metër, tarifa është 20 000 (njëzet mijë) lekë.

1.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 32 deri në 54 metër, tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

2. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik (sektori i bujqësisë, sektori i industrisë, sektori i transportit, sektori i tregtisë, sektori i turizmit, sektori i shërbimeve, etj.)

2.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 500 m², tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë.

2.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 1 000 m², tarifa është 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

2.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes



nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 2000 m², tarifa është 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 3000 m², tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

2.5 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi mbi 3000 m², tarifa është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, përveç objekteve të përcaktuara në pikën 2, të kësaj shtojce, për objektet/aktivitetet me rrezikshmëri të lartë zjarri

3.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente për përpunimin e drurit me materiale në përpunim dhe/ose në ruajtje, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

3.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për fabrika dhe impiante ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbahen produktet e tekstilit, natyrore/artificiale, produktet e linoleum-it dhe produkte të tjera të ngjashme, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

3.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, përpunimin dhe rigjenerimin e laboratorëve të gomës, depozitat e gomës, pneumatikëve dhe produkteve të ngjashme, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

3.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe

shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për depot ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbajnë plastikë, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

3.5 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, letër dhe karton, dhe përgatitja e produkteve të letrës në përgjithësi, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

4. Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet ku janë të instaluar pajisje nën presion

4.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 75 kg deri në 300 kg, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

4.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 300 kg deri në 1000 kg, tarifa është 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

4.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 1000 kg, tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë.

4.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impiante ku lëngjet e ndezshme dhe/ose të djegshme me pikë ndezjeje prodhohen dhe/ose përdoren deri në 125°C, me sasi totale në cikël dhe/ose në ruajtje, më e madhe se 1 m³, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

4.5 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impiantet për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave



diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri në 5 m³, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

4.6 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impianete për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri 100 m³, tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë.

4.7 Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impianete për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajra diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje mbi 100 m³, tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë.

4.8 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme të shpërndarjes së karburantit të lëngshëm, kontejnerët e palëvizshëm të karburanteve të lëngshëm deri në 9 m³, me pikë të ndezjes mbi 65°C, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

4.9 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme fikse për shpërndarjen e karburanteve të gaztë dhe tipit të përzier (të lëngshëm dhe të gaztë), tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë.

4.10 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme të shpërndarjes së gazit të karburantit për automjete motorike dhe sisteme të shpërndarjes së palëvizshme për benzinë, naftë dhe miksa automobilistik, për përdorim publik dhe privat, tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë.

5. Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet e mëposhtme:

5.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për hidrocentrale, HEC (primar, sekondar) etj., impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, të rinovueshme, diellore, ere, etj., tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë.

5.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për vend depozitime të mbetjeve të ngurta, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

5.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për rrugë, hekurudha, ura, tunele, tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë.

6. Për vlerësimin dhe miratimin e ndryshimeve të projektit të MZSH-së, të miratuar më parë nga struktura e MZSH-së, për shkak të instalimit të sistemeve të reja, zgjerimit apo ristrukturimit të aktiviteteve ekzistuese, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë.

7. Për dhënien e certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet që ushtrojnë aktivitete, sipas klasifikimit të rrezikshmërisë nga zjarri, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë.

8. Për ripërtëritjen periodike të certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është 2 000 (dy mijë) lekë.

9. Për lëshimin e vërtetimit të zjarrit (shoqëruar nga raporti i ndërhyrjes), nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është 1 000 (një mijë) lekë.

10. Për lëshimin e vërtetimit (shoqëruar nga akti i kontrollit i kryer nga inspektori i shërbimit të MZSH-së), për depozitat e gazeve të ndezshme, të ngurta, apo plazma në automjete të lëvizshme rrugore, nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është 1 000 (një mijë) lekë.

11. Për inspektimin e objekteve për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kur inspektimi nuk është i autorizuar nga shërbimi i MZSH-së, por kërkohet nga vetë subjektet fizikë dhe juridikë, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë për një orë.

12. Për vënien në dispozicion të personelit dhe të një automjeti në zhvillimin e aktiviteteve



sportive, kulturore, si panairë, ekspozita, koncerte, shfaqje, festivale të ndryshme, në mjedise të hapura dhe të mbyllura publike, si dhe gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive kombëtare apo ndërkombëtare, tarifa është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për një orë.

13. Për ofrimin e shërbimeve subjekteve private me automjete zjarrfikëse, me pajisje zjarrfikëse, apo me auto shkallë, tarifa është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për një orë.

14. Për ofrimin e shërbimit me motopompë (largim të ujërave për shkak të reshjeve), subjekteve private, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë për një orë.

15. Për trajnimin e personave, të subjekteve fizikë dhe juridikë për mbrojtjen nga zjarri nga strukturat e shërbimit të MZSH-së në Akademinë e Sigurisë (Qendra e Trajnimit Zjarrfikës), tarifa është 2 000 (dy mijë) lekë në ditë për person.

16. Për kryerjen e aktit të ekspertimit apo riekspertimit, nga strukturat e MZSH-së së bashkisë, në rastet e zjarreve të rëna në objekt, kur kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë, tarifa është 20 000 (njëzetë mijë) lekë. Kjo tarifë nuk aplikohet kur akti i ekspertimit kërkohet nga Prokuroria.

17. Për të gjitha ndërhyrjet kur kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë (zhbllokime dyersh, ashensorë, apo shërbime të tjera të ngjashme), që do të kryhen nga shërbimi zjarrfikës i bashkisë, tarifa është 2 000 (dy mijë) lekë.

VENDIM

Nr. 608, datë 29.7.2020

PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT TË PERSONAVE TË DALË TË PAPUNË SI PASOJË E COVID-19

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19, nga data 10 mars 2020 deri në datën 23 qershor 2020.

2. Programi, sipas pikës 1, të këtij kreu, zbatohet në përputhje me nevojat individuale të punëkërkuarit të papunë për t'u integruar në tregun e punës dhe me planin individual për punësimin e tij.

II. KRITERET E KËRKESËS

1. Punëkërkuarit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuarit e papunë që kanë dalë të papunë si pasojë e COVID-19, të evidentuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe të regjistruar në zyrën e punës.

2. Punëkërkuari, pjesëmarrës në programet sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, nuk mund të zëvendësohet.

3. Një punëkërkuar mund të marrë pjesë vetëm një herë në këtë program.

4. Punëdhënësit me të drejtë kërkese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Të jenë shoqëri tregtare të regjistruara;

b) Të jenë subjekt i pagimit të taksave dhe të jenë të regjistruar si punëdhënës pranë autoriteteve tatimore;

c) Të mos kenë shkelur legjislacionin për punësimin në dy vitet e fundit përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi;

ç) Të ofrojnë punë me kohë të plotë, për një minimum prej 40 (dyzet) orësh në javë, me një pagesë mujore jo më pak se paga minimale, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës;

d) Vendi i punës, i financuar nga ky program, duhet të vijë si rezultat i rritjes së fuqisë punëtore në aktivitetin e punëdhënësit;

dh) Të jenë shoqëri tregtare, të cilat nuk kanë detyrime ndaj organeve tatimore para datës 10 mars, në bazë të akteve normative në fuqi ose, në momentin e kërkesës për këtë program, të vërtetojnë se:

i. kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullta në shlyerjen e tyre;



ii. kanë shlyer detyrimet por kanë ende pa paguar gjokat;

iii. kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ e në procese gjyqësore me organet tatimore.

III. PROGRAMET, PËRFITUESIT DHE MBËSHTETJA

1. Programi i punësimit përmban elementet, si më poshtë vijon:

a) Programi i punësimit është një program 4, 8 ose 12-mujor punësimi, në të cilin profili dhe nevojat e punëkërkuarit përshtaten me vendin e lirë nga punëdhënësi;

b) Paga përcaktohet në kontratën e punës, në përputhje me pozicionin përkatës dhe nivelin e pagave në treg.

2. Programi subvencionon kostot e mëposhtme:

a) Për programin e punësimit katërmujor:

i. financimin e pagës në shumën 100% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për 2 (dy) muaj për të gjithë pjesëmarrësit në program, të kompensuara në muajin e parë dhe të katërt të kontratës;

ii. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuara çdo muaj.

b) Për programin e punësimit tetëmuajor:

i. financimin e pagës në shumën 100% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për 4 (katër) muaj, për të gjithë pjesëmarrësit në program, të kompensuara në muajin e parë, të dytë, të shtatë dhe të tetë të kontratës;

ii. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuara çdo muaj.

c) Për programin e punësimit 12 (dymbëdhjetë) muajor subvencionon kostot e financimit të sigurimeve të detyrueshme

(kontribut i punëdhënësit dhe punëmarrësit) në masën 100%, të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit, të kompensuara çdo muaj.

IV. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT

Procedura e përgjithshme e zbatimit të këtyre programeve përfshin hapat, si më poshtë vijon:

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, nëpërmjet strukturave të tij, publikon informacionin e nevojshëm në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera (faqe interneti, media sociale, shtyp etj.) lidhur me zbatimin e programit.

2. Punëdhënësit mund të kërkojnë për përfshirjen në program në rrugë elektronike, duke ngarkuar në faqen e internetit:

a) formularin përkatës të plotësuar, sipas modelit standard të miratuar dhe të publikuar nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;

b) autorizimin e punëdhënësit, me të cilin autorizohet institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për të kryer të gjithë verifikimet dhe kërkimet e nevojshme të dokumenteve dhe të të dhënave të kërkesës;

c) vetëdeklarim për mospasjen në ngarkim të punëdhënësit, të shkeljeve apo të sanksioneve që lidhen me legjislacionin e punës, përgjatë dy viteve të fundit.

3. Pas marrjes së kërkesës nga punëdhënësi, struktura vendore e punësimit kryen verifikimet e nevojshme.

4. Struktura vendore e punësimit verifikon, brenda 7 (shtatë) ditëve pune, plotësimin e kushteve formale paraprake të kërkesës dhe përputhshmërinë e tij me rregullat e zbatueshme të programit.

5. Në rast të mosplotësimit të kushteve paraprake, struktura vendore e punësimit i kërkon kërkuesit plotësimin e dokumentacionit.

6. Në rast të plotësimit të kushteve paraprake, struktura vendore i përcjell për miratim kërkesën strukturës rajonale të punësimit, e cila, brenda 5 (pesë) ditëve pune, vendos miratimin ose mosmiratimin e projektit, sipas rregullave të përcaktuara në manualin e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit.



7. Struktura vendore e punësimit i komunikon punëdhënësit kërkesë përgjigjen përfundimtare për pranimin apo refuzimin e kërkesës, brenda 2 (dy) ditëve pune. Ndaj këtij vendimi nuk paraqitet ankim administrativ.

8. Punëdhënësi dhe punëkërkesi, në cilësinë e punëmarrësit, lidhin një kontratë pune, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, në përputhje me programin e përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi. Një kopje e kontratës së punësimit dorëzohet në strukturën vendore të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, i cili do të monitorojë zbatimin e saj deri në përfundim të projektit.

9. Pas nënshkrimit të kontratës së punës nënshkruhet marrëveshja tripalëshe për zbatimin e programit.

10. Nëse punëdhënësi zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën me përfituesin për shkaqe të pajustificuara, punëdhënësi është i detyruar të kthejë 100% të mbështetjes financiare të përfituar deri në atë moment.

11. Nëse punëdhënësi nuk respekton marrëveshjen tripalëshe për zbatimin e programit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, ai përjashtohet nga pjesëmarrja në program për një periudhë katërvjeçare.

12. Financimi i punëdhënësit do të bëhet çdo muaj, pas verifikimit nga struktura përkatëse e punësimit të kryerjes së pagesës nga ana e tij.

13. Monitorimi i zbatimit kryhet nga strukturat përkatëse të punësimit (institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë).

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë përgatit raportin vjetor, brenda datës 31 marsit të vitit pasardhës dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

2. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ruan të dhënat për programet 10 (dhjetë) vjet, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Vlerësimi i ndikimit të programit kryhet 2 (dy) vjet pas zbatimit të tij, nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë.

4. Ngarkohet institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për hartimin e rregulloreve të zbatimit të programit të nxitjes së punësimit,

brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM Nr. 609, datë 29.7.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 47, DATË 22.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2020, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 2 597 (dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) veta.

2. Në pikën 3, pas fjalëve: “... 14 specialistë të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ...” shtohet fjalia: “..., 1 specialist të Drejtorisë së Pagesave dhe Dëshmipërblimeve, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe 5 mjekë, 5 specialistë dhe 5 punonjës socialë të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, periudha kohore e të cilëve bëhet deri në fund të vitit.”.

3. Pas pikës 3, shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:



“3.1. Në mbështetje të nevojave të spitaleve të dedikuara për COVID-19, me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, një pjesë e 700 punonjësve të kontraktuar pranë drejtorive rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, sipas lidhjes nr. 1, të pikës 1, të vendimit, mund të caktohen për të punuar përkohësisht pranë stafit organik të këtyre spitaleve.

Për kohën e punuar në këto spitale, punonjësit e kontraktuar paguhën në përputhje me pagën dhe përfitimet e tjera financiare të pozicionit të punës në të cilin caktohen.”.

4. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, bëhen këto ndryshime:

a) Në ndarjen “Gr. 10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, nënndarja si më poshtë vijon:

Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve	4	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
--	---	------------	------------	--------

zëvendësohet me nënndarjen:

Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve	1	Specialist	8 orë/ditë	Vjetore
--	---	------------	------------	---------

b) Në ndarjen “Gr. 13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, nënndarja si më poshtë vijon:

Drejtoria Rajonale e SH.S.SH Tiranë	5	Mjek	8 orë/ditë	6-Muaj
Drejtoria Rajonale e SH.S.SH Tiranë	5	Punonjës Social	8 orë/ditë	6-Muaj
Drejtoria Rajonale e SH.S.SH Tiranë	5	Specialist	8 orë/ditë	6-Muaj
Drejtoritë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor	700	Specialist (Infermier/teknik i shkencave mjekësore)	8 orë/ditë	6 Muaj

zëvendësohet me nënndarjen:

Drejtoria Rajonale e SH.S.SH Tiranë	5	Mjek	8 orë/ditë	vjetore
Drejtoria Rajonale e SH.S.SH Tiranë	5	Punonjës Social	8 orë/ditë	vjetore
Drejtoria Rajonale e SH.S.SH Tiranë	5	Specialist	8 orë/ditë	vjetore
Drejtoritë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor	700	Specialist (Mjek/ Stomatolog/Farmacit/Shëndet Publik/Teknik i Shkencave Mjekësore)	8 orë/ditë	6 Muaj

c) Në ndarjet “Gr. 05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” dhe “Gr. 10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, shtohen nënndarjet sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Efektet financiare për 1 punonjës pranë Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve dhe 15 punonjës të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë fillojnë nga data 1 korrik 2020 dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që të bëjnë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre dhe ta depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Tabela nr.1

Gr.	Emri i Institucionit		Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	303			
	Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve	235	Specialist (Veteriner)	8 orë/ditë	4 -Muaj
	Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve	65	Teknik i mesëm (Veteriner)	8 orë/ditë	4 -Muaj
	Aparati MBZHR	2	Sanitar	6 orë/ditë	5 -Muaj
	AREB Lushnje	1	Punëtor mirëmbajtje	8 orë/ditë	5 -Muaj
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	16			
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike)	2	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Përgjithme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj)	2	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar)	1	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	Aparati i Ministrisë (Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore)	1	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë	2	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	3	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Menaxhimit të Programeve dhe Projekteve në Fushën e Zhvillimit Ekonomik dhe Arsimit Profesional)	1	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Fondit Kombëtar)	2	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit)	1	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësisimit Profesional)	1	Specialist	8 orë/ditë	5 -Muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	319			

VENDIM

Nr. 610, datë 29.7.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR
PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
(AKSHI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2020, i shtohet fondi prej:

a) 370 000 000 (treqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, në zërin “shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit buxhetor 01140 “e-*Qeverisja*”, për projektet e investimeve në sistemet IT.

b) 630 000 000 (gjashtëqind e tridhjetë milionë) lekësh, në zërin “shpenzime operative & mirëmbajtje”, të programit buxhetor 01140 “e-*Qeverisja*”, për kontratat në vazhdim të mirëmbajtjes së sistemeve IT.

2. Efekti financiar, prej 1 000 000 000 (një miliard) lekësh, përballohet në masën:

a) 140 000 000 (njëqind e dyzet milionë) lekë, nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zërin “shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit buxhetor 04520 “Transporti rrugor”.

b) 860 000 000 (tetëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.



3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 611, datë 29.7.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2020, i shtohet kundërvlefata në lekë e shumës prej 20 000 (njëzet mijë) eurosh, në zërin: “shpenzime korrente”, të programit 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim”, për pagesën e kontributit financiar të vendit tonë në Fondin e Mirëbesimit të NATO-s.

2. Efekti financiar i kundërvlehtës në lekë, të shumës prej 20 000 (njëzet mijë) eurosh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 612, datë 29.7.2020

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
MASËS SË SHPËRBLIMIT TË
ANËTARËVE TË KËSHILLAVE,
BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË NJËSIVE TË
QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të lidhjes nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, shtohet lidhja që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për komisionet/këshillat/bordet, sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi, fillojnë nga momenti i funksionimit të tyre dhe përballohen, përkatësisht, nga buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i Ministrisë së Kulturës.

Efektet financiare për Komisionin e Policisë Gjyqësore përballohen nga buxheti i secilit institucion, të përfaqësuar në këtë komision.

3. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Emertesa e Bordit/Keshillit/Komisionit	Numri maksimal i pagesave ne nje vit	Përbërja		Masa e shperblimit në Lekë	
		Kryetari	Nr. i Anetareve	Kryetari	Anëtari
Komisioni i Policisë Gjyqësore	12	1	4	20,000	15,000
Komisioni Qendror i Statusit "Dëshmor i Atdheut"	5	1	6	7,000	7,000
Bordi i Administrimit të Fondit Social të Punësimit	6		9		10,000
Këshillat Konsultativ Trepalësh Rajonal	4	1	14	5000	5000
Zyra Kombëtare e Pajtitimit		1	4		Paga ditore e Dr. Drejtorise * nr. i diteve per pjesemarrje ne mbledhje
Zyrat Rajonale të Pajtitimit		1	4		Paga ditore Dr.te Zyres Rajonale * nr. i diteve per pjesemarrje ne mbledhje
Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale	4	1	14	5,000	5,000
Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale	4	1	10	5,000	5,000
Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore	6	1	10	5000	5000
Këshilli Kombëtar i Muzeve	4	1	10	5,000	5,000

VENDIM

Nr. 614, datë 29.7.2020

PËR SHEMBJEN E KATËR OBJEKTEVE TË DHËNA ME QIRA, ME KONTRATËN E QIRASË NR. 1998 REP., NR. 767 KOL., DATË 19.4.2019, ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE FONDACIONIT "FUNDJAVË NDRYSHE", SI QIRAMARRËS, NË ADMINISTRIM TË NDËRMARRJES INDUSTRIALE NR. 1, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të pikës 7, të kreut VIII, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shembjen e katër objekteve me emërtimet: objekti nr. 8 "Godinë, ish-ndërtesa gr. shkencor", objekti nr. 10 "Depo", objekti nr. 11 "Godinë, ish-optika e re" dhe objekti nr. 12 "Ish-magazinë rikupero", pjesë përbërëse e pronës me nr. 109, me emërtim "Sh.a. riparim artilerie", të dhëna me qira me kontratën e qirasë nr. 1998 rep., nr. 767 kol., datë 19.4.2019, me tarifën 1 euro/kontrata, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe fondacionit "Fundjavë ndryshe", si qiramarrës, miratuar me vendimin nr. 118, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me nr. pasurie 969/12, zona kadastrale 1263, në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ndërmarrja Industriale nr. 1, Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Tabela nr. 1

Lista e objekteve në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, që do të shemben

Nr.	Njësia që e administron	Nr. pronës/vendndodhja	Emërtimi i ndërtesës	Sipërfaqja (m ²)	Vlera e 3 objekteve (lekë)
1	Ndërmarrja Industriale nr. 1	nr. 8, Brar, Tiranë	Objekti nr. 8 – Godinë, ish-ndërtesa gr. shkencor	163.62	202.68
2	Ndërmarrja Industriale nr. 1	nr. 10, Brar, Tiranë	Objekti nr. 10 - Depo	144	332.301
3	Ndërmarrja Industriale nr. 1	nr. 11, Brar, Tiranë	Objekti nr. 11 – Godinë, ish-optika e re	1036.85	1.681.047
4	Ndërmarrja Industriale nr. 1	nr. 12, Brar, Tiranë	Objekti nr. 12 - Ish-magazinë rikupero	981.26	1.870.579
	SHUMA				4.086.607

VENDIM

Nr. 616, datë 29.7.2020

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË
NGA AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
TE BASHKIA TIRANË, TË
SEGMENTEVE RRUGORE DYTËSORE,
KTHESA E KAMZËS–VORË (PARALELE
DJATHTAS) DHE KTHESA E KAMZËS–
VORË (PARALELE MAJTAS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 7 e 8, të nenit 2, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë nga Autoriteti Rrugor Shqiptar te Bashkia Tiranë, të segmenteve rrugore dytësore, kthesa e Kamzës–Vorë (paralele djathtas) dhe kthesa e Kamzës–Vorë (paralele majtas), deri brenda kufirit të Bashkisë Tiranë.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 617, datë 29.7.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “RRUGA E
ARBRIT” (SHITESA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga e Arbrit” (shtesa).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “arë” dhe “pemëtores”, me vlerë 16 808 960 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë.



4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 16 808 960 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekësh të përballohet nga fondet buxhetore për vitin 2020, të miratuara në zërin “Shpronësime”, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor “Transporti rrugor”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËTIMI I SEGMENTIN RRUGOR “RRUGA E ARBRIT” (SHITESA)

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË						SHËNIME	
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. Totale (m ²)	Shpronësim tokë “arë”			Shpronësim tokë “truall”				VLERA TOTALE (lekë)
								Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
1	HAJDAR	AVDULLA	JANAKU	1124	1123	ARË	329	329	448					147392	Konf. ASHK, me shkresën nr. 1830/1, datë 3.7.2019
2	HAJDAR	ABDULLA	JAMAKU	1124	1127	PEMËTORE	514	514	448					230272	Konf. ASHK
3	HAJDAR	ABDULLA	JAMAKU	1124	1126	ARË	923	923	448					413504	Konf. ASHK
4	REXHEP	REXHEP	JAMAKU	1124	1115	ARË	664	622	448					278656	Konf. ASHK
5	RAMAZAN	ALI	META	1124	1160	ARË	1706	644	448					288512	Konf. ASHK
6	FIQIRI	QAMIL	META	1124	1163	ARË	1353	90	448					40320	Konf. ASHK
7	XHELAL	ALI	META	1124	1161	ARË	1794	549	448					245952	Konf. ASHK
8	XHEMAL	QAMIL	META	1124	1162	ARË	1537	338	448					151424	Konf. ASHK
9	BAJRAM	OSMAN	META	1124	1164	ARË	4210	13	448					5824	Konf. ASHK
10	SHABAN	SALI	DERVISHI	1124	1165	ARË	5255	2219	448					994112	Konf. ASHK
11	LUAN	HYSEN	STAFI	3876	258/2	ARË	1241.8	30	448					13440	Konf. ASHK
12	ABAZ	RESHEF	LILA	1124	1159	ARË	1263	476	448					213248	Konf. ASHK
13	MUSTAFA	SALI	LILA	1124	1184	ARË	1099	1099	448					492352	Konf. ASHK
14	MUSTAFA	SALI	LILA	1124	1183	ARË	4190	1145	448					512960	Konf. ASHK
15	ABAZ	RESHEF	LILA	1124	1181	ARË	2180	1992	448					892416	Konf. ASHK
16	RABIE	ISUF	LILA	1124	1182	ARË	4190	3782	448					1694336	Konf. ASHK
17	ELMAZ	ISUF	LILA	1124	1178/1	ARË	3135	2359	448					1056832	Konf. ASHK
18	GËZIM	ISUF	LILA	1124	1178/2	ARË	3134	160	448					71680	Konf. ASHK
19	SELIM	SALI	LILA	1124	1152	ARË	10247	4969	448					2226112	Konf. ASHK
20	AVDI	HAJDAR	JAMAKU	1124	1146	ARË	1605	439	448					196672	Konf. ASHK
21	HALLIL	SALI	LILA	1124	1136	ARË	4932	1273	448					570304	Konf. ASHK
22	MEHMET	ABDYLL	JAMAKU	1124	1144	ARË	3194	556	448					249088	Konf. ASHK
23	REXHEP	REXHEP	JAMAKU	1124	1148	ARË	5081	3095	448					1386560	Konf. ASHK
24	XHEVAHIR	ISUF	LILA	1124	1172	ARË	498	498	448					223104	Konf. ASHK
25	NURI	BESHIR	HOXHA	1124	1170	ARË	435	435	448					194880	Konf. ASHK
26	NURI	BESHIR	HOXHA	1124	1168	ARË	1476	885	448					396480	Konf. ASHK
27	NURI	BESHIR	HOXHA	1124	1169	ARË	629	129	448					57792	Konf. ASHK
28	XHEVAHIR	ISUF	LILA	1124	1171	ARË	1490	172	448					77056	Konf. ASHK
29	XHEVAHIR	ISUF	LILA	1124	1173	ARË	8514	174	448					77952	Konf. ASHK
30	NURI	BESHIR	HOXHA	1124	1174	ARË	5919	2523	448					1130304	Konf. ASHK
31	MUSTAFA	SALI	LILA	1124	1176	ARË	3808	1639	448					734272	Konf. ASHK
32	ABAZ	RESHEF	LILA	1124	1179	ARË	680	528	448					236544	Konf. ASHK



33	HALIL	SALI	LILA	1124	1135	PEMËTORE	594	594	448					266112	Konf. ASHK
34	HALIL	SALI	LILA	1124	1138	ARË	420	310	448					138880	Konf. ASHK
35	REXHEP	REXHEP	JAMAKU	1124	1129	PEMTORE	233	233	448					104384	Konf. ASHK
36	AVDI	HAJDAR	JAMAKU	1124	1128	ARË	326	326	448					146048	Konf. ASHK
37	HAMZA	SUL	NASUFI	3876	316/3	ARË	320	233	448					104384	Konf. ASHK
38	ALI	BEQIR	HUSHA	3876	250/2	ARË	1460	678	448					303744	Konf. ASHK
39	HAXHI	SUL	NASUFI	3876	316/13	ARË	1400	374	448					167552	Konf. ASHK
40	RAMAZAN	SHABAN	AHMETI	3876	316/10	ARË	1090	173	448					77504	Konf. ASHK Kufizim mbi pasurinë
SHUMA								37520						16808960	



VENDIM
Nr. 618, datë 29.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 718, DATË 20.10.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR, UNAZA E
MADHE E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 718, datë 20.10.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3, 4 dhe 5, ndryshohen si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 16 978 (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) m², me vlerë 44 519 117.37 (dyzet e katër milionë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë, për

Lista e pronarit që shpronësohet

Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 718, datë 20.10.2011, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Unaza e Madhe e Tiranës”

Vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.8.2000, i ndryshuar Udhëzimit nr. 1, datë 05.10.2000, “Për kriteret teknike të përllogaritjes së vlerës së drufruturëve”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Vlera e kulturave bujqësore dhe drufruturëve (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime
1	Shyqyri		Brahja	3266	84/7	382,400	382,400	Sipas procesverbalit
SHUMA TOTALE						382,400	382,400	

objekte, me vlerë 24 323 494 (njëzet e katër milionë e treqind e njëzet e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë dhe kultura drufrutore me vlerë 382 400 (treqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 69 225 011.37 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e njëzet e pesë mijë e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen:

- nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë;

- nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 69 225 011.37 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e njëzet e pesë mijë e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë, të përballohet:

- nga buxheti i vitit 2011 zëri “investime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, vlera 68 842 611.37 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë;

- nga fondet buxhetore për vitin 2020, të miratuar në zërin “Shpronësime”, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor “Transporti rrugor”, vlera 382 400 (treqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM

Nr. 619, datë 29.7.2020

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ZGJERIMI I HAPËSIRËS
SË VARREZAVE”, NË FSHATIN ÇERMË
E SIPËRME, NJËSIA ADMINISTRATIVE
TËRBUF, BASHKIA DIVJAKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i hapësirës së varrezave”, në fshatin Çermë e Sipërme, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Divjakë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “tokë arë”, me vlerë të përgjithshme prej 2 147 600 (dy milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, me vlerë prej 2 147 600 (dy milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2020, i miratuar për Bashkinë Divjakë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Divjakë.

8. Bashkia Divjakë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Divjakë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Bashkinë Divjakë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Divjakë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Divjakë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Divjakë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Divjakë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pronarit të pasurisë, pronë private, që preket nga realizimi i projektit:
“Zgjerimi i hapësirës së varrezave”, në fshatin Çermë e Sipërme, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqja “tokë arë” (m ²)	Çmimi i “tokë arë” (lekë/m ²)	Vlera totale (lekë)	Shënime konfirmuar nga ZVRPP-ja
1	1381	200/50	Fshati Çermë e Sipërme	Selman Hekuran Hoxha	5900	364	2,147,600	Kërkesë nr. 576 prot., datë 6.2.2020; kthim përgjigje nr. 1550/1 prot., datë 10.2.2020, protokolluar nga Bashkia Divjakë me nr. 576/1, datë 11.2.2020.
Total							2,147,600	

Shënime:

1. Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë arë”, është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.



VENDIM
Nr. 620, datë 29.7.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE
TË MËNYRËS SË PËRFITIMIT TË
MBROJTJES SË VEÇANTË TË
GARANTUAR NGA SHTETI PËR
PËRMBARUESIN GJYQËSOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27, të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor”, të ndryshuar, dhe të nenit 39, të ligjit nr.26/2019, “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përmbarruesit gjyqësor, shtetëror dhe privat, i sigurohet mbrojtje e veçantë personale, e familjes dhe e pronës, sipas parashikimeve të këtij vendimi, kur gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj, i rrezikohet jeta dhe shëndeti i tij ose i familjes si dhe prona.

2. Me mbrojtje të veçantë personale të familjes dhe të pronës, sipas këtij vendimi, do të kuptohen masat me karakter organizativ e profesional, për sigurimin dhe ruajtjen e veçantë fizike, mbrojtjen e familjes e të pronës së përmbarruesit gjyqësor, si dhe masat e tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

3. Kushtet për të përfituar mbrojtje të veçantë janë, si më poshtë vijon:

a) Prania e rrethanave serioze, që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e përmbarruesit gjyqësor;

b) Lidhja shkakësore ndërmjet rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e përmbarruesit gjyqësor dhe ushtrimit të detyrës.

4. Kërkesa për mbrojtje të veçantë i paraqitet komisionit me shkrim nga përmbarruesi gjyqësor, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, ministri i Drejtësisë, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit, kryetari i Dhomës Kombëtare të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, si dhe çdo organ tjetër publik, që, për shkak të funksionit, merr dijeni për praninë e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e përmbarruesit gjyqësor.

5. Kërkesa për mbrojtje të veçantë përmban:

a) gjenealogjet e plota të kërkuarit;

b) një përmbledhje të fakteve e të rrethanave, që përbëjnë rrezik serioz për përmbarruesin gjyqësor, të cilat detyrojnë të sigurohet mbrojtje e veçantë, si dhe burimin e provave, ku bazohen ato;

c) llojin e masave që kërkohen dhe kohëzgjatjen e tyre.

6. Kërkesa për mbrojtje i paraqitet komisionit nga subjektet e përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, kur ka të dhëna të besueshme që provojnë se një përmbarruesi gjyqësor, shtetëror ose privat, i rrezikohet jeta, familja ose prona.

7. Kur rreziku ndaj përmbarruesit gjyqësor është serioz dhe i çastit, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron strukturat e Policisë së Shtetit të marrin masa të menjëhershme për të garantuar jetën, familjen ose pronën e përmbarruesit gjyqësor, deri në mbledhjen e komisionit. Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerëson masat e marra nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe vendos, kur është rasti, për vazhdimin e mëtejshëm të tyre ose ndërprerjen e mbrojtjes së veçantë.

8. Kërkesat për sigurimin e mbrojtjes së veçantë shqyrtohen nga Komisioni për Mbrojtjen e Përmbarruesve Gjyqësorë, i cili ngrihet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë, me përbërje si më poshtë vijon:

a) Një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, i caktuar nga ministri, i cili është njëkohësisht edhe kryetari i komisionit;

b) Një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, i caktuar nga drejtori i Përgjithshëm i Përmbarrimit;

c) Një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, i caktuar ministri;

ç) Një përfaqësues i Dhomës së Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, i caktuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës.

9. Kryetari i komisionit ushtron këto funksione:

a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e komisionit;

b) përfaqëson komisionin në marrëdhëniet me të tretët;

c) siguron mbështetjen administrative dhe organizative për funksionimin e komisionit;

ç) siguron dokumentimin e mbledhjes së komisionit dhe mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat;

d) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi.



10. Kryetari, menjëherë pas marrjes së kërkesës për mbrojtje, njofton anëtarët e komisionit për mbledhjen e radhës. Komisioni duhet të mbledhet menjëherë dhe jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga paraqitja e kërkesës, sipas pikës 6 të këtij vendimi.

11. Ministria e Drejtësisë siguron mbështetjen e nevojshme organizative e administrative për realizimin e funksionit dhe të detyrave të komisionit.

12. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se tre anëtarë të tij. Vendimet janë të vlefshme kur miratohen të paktën nga shumica e anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

13. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim, të cilat, plotësohen, për aq sa nuk bie ndesh me dispozitat e këtij vendimi, nga rregullat e parashikuara në legjislacionin për organizimin e funksionimin e organeve kolegjiale. Pjesëmarrja në mbledhjet e komisionit është e detyrueshme. Kryetari i komisionit, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, cakton një sekretar nga nëpunësit e strukturës përgjegjëse për profesionet e lira në Ministrinë e Drejtësisë, i cili mban procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes.

14. Komisioni, në procesin e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje të veçantë të familjes e të pronës, sipas këtij vendimi, mund të kërkojë informacione nga institucione të tjera.

15. Komisioni merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur dhe, kur bindet për nevojën e sigurimit të mbrojtjes për përmbaruesit gjyqësor, me vendim miraton mbrojtjen e veçantë të përmbaruesit gjyqësor. Vendimi përmban masat konkrete të mbrojtjes së veçantë, numrin e shoqëruesve personalë, kur është rasti, afatin, brenda të cilit sigurohet mbrojtja, si dhe masa të tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

16. Vendimi i komisionit i njoftohet përmbaruesit gjyqësor nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit ose Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe strukturave përgjegjëse për mbrojtjen, nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

17. Komisioni, me kërkesë të subjekteve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, kur ka të dhëna të besueshme që provojnë se një përmbaruesi gjyqësor i rrezikohet jeta, familja ose prona, mund të vendosë zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes, nëse rrethanat, për të cilat është siguruar më parë mbrojtja, vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të këtij afati.

18. Në rast se rreziku ndaj jetës, familjes ose pronës së përmbaruesit gjyqësor nën mbrojtje pushon së ekzistuari përpara përfundimit të afatit të mbrojtjes, sipas përcaktimit në vendimin e komisionit, me kërkesën e çdo subjekti të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, komisioni mund të vendosë të ndërpresë mbrojtjen e veçantë të përmbaruesit gjyqësor.

19. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 621, datë 29.7.2020

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. HELKI KAMBERI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 42, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Helki Kamberi, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.



3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 622, datë 29.7.2020

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE
TË MJEKIMIT
TË Z. THEODHORI BANUSHI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 42, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Theodhori Banushi, në masën 900 000 (nëntëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 623, datë 29.7.2020

**PËR MIRATIMIN E PAKETËS SË
PROGRAMIT TË DEPISTIMIT TË
KANCERIT TË GJIRIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit kombëtar të depistimit të kancerit të gjirit në Shqipëri, si një paketë shërbimesh ndihmëse në shëndetin publik, që përfshin ekzaminimet sistematike nëpërmjet palpimit të gjirit dhe mamografisë, ekzaminimet e mëtejshme diagnostikuese dhe trajtimin për të gjitha gratë që diagnostikohen me kancer, të përfshira në program, me qëllim identifikimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe uljen e vdekshmërisë nga kanceri i gjirit.

2. Shërbimet e organizuara të këshillimit, të informimit të grave mbi programin dhe ekzaminimit me palpim të gjirit do të kryhen pranë qendrave shëndetësore të shërbimeve të kujdesit parësor.

3. Shërbimi i ekzaminimit me mamografi do të ofrohet në qendrat e mamografisë, pranë shërbimit spitalor publik, poliklinikave të specialiteteve dhe njësitë e lëvizshme të mamografive.

4. Shërbimet e diagnozës së mëtejshme dhe të trajtimit eventual mjekësor do të ofrohen për të gjitha gratë që rezultojnë pozitive në depistim, pas kryerjes së mamografisë.

5. Shërbimet e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, ofrohen pa pagesë, si pjesë e kësaj pakete të shërbimeve ndihmëse të shëndetit publik, duke zbatuar sistemin e referimit.

6. Kryerja e ekzaminimeve të mëtejshme në procesin e konfirmimit të diagnozës së kancerit të gjirit dhe trajtimi do të kryhet pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe spitaleve të caktuara rajonale, të cilat sigurojnë kapacitetet e nevojshme lidhur me diagnozën.

7. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve lidhur me



ekzaminimin e mamografisë dhe trajtimin, në spitalet rajonale, me qëllim uljen e vazhdueshme të barrierave gjeografike për gratë e përfshira në program.

8. Programi të garantojë qëndrueshmërinë afatgjatë të shërbimit, rritjen e vazhdueshme të mbulesës depistuese dhe cilësi në të gjitha nivelet e shërbimeve të ofruara.

9. Instituti i Shëndetit Publik, në bashkëpunim me njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, në varësi të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, duhet të sigurojë kryerjen e ekzaminimit të mamografisë për gratë e përfshira në këtë program, afër vendbanimit për zona të largëta urbane dhe rurale, nëpërmjet mamografive të lëvizshme.

10. Qendrat shëndetësore duhet të sigurojnë informimin, këshillimin dhe ekzaminimin me palpim të gjirit për gratë e përfshira në program. Mjekët e familjes duhet të mbështesin me informacion gjatë gjithë procesit të diagnozës dhe trajtimit gratë që rezultojnë pozitive.

11. Instituti i Shëndetit Publik, Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, të sigurojnë trajnimin e duhur për personelin shëndetësor, mjekë dhe infermierë, të këtyre qendrave.

12. Instituti i Shëndetit Publik organizon në vijimësi aktivitetet kombëtare dhe rajonale ndërgjegjësuese të popullatës dhe, në bashkëpunimin me Operatorin e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, siguron ndërgjegjësimin dhe informimin e vazhdueshëm të publikut lidhur me depistimin dhe diagnozën e hershme të kancerit të gjirit.

13. Instituti i Shëndetit Publik i propozon për miratim Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kornizën teknike të programit me popullatën target, standardet, mekanizmat e sigurimit të cilësisë, menaxhimin e riskut dhe treguesit e monitorimit të procesit. Instituti i Shëndetit Publik, në bashkëpunim me Operatorin e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, si dhe strukturën përgjegjëse për cilësinë, standardet dhe akreditimin, përditëson në vijimësi kornizën teknike në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

14. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 624, datë 29.7.2020

**PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E
PROGRAMIT TË CERTIFIKIMIT TË
PROFESIONISTËVE TË SHËRBIMEVE
TË KUJDESIT SHOQËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 42, të ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim rregullon kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit për profesionistët e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

2. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Ministër”, ministri përgjegjës për çështjet sociale;

b) “Psikolog”, ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”;

c) “Punonjës social”, ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin “Për Urdhrin e Punonjësve Social në Republikën e Shqipërisë”;

ç) “Ligj”, ligji nr. 121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;

d) “Edukimi i vazhdueshëm”, procesi nëpërmjet të cilit profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror përditësojnë dijet dhe aftësitë e tyre për të plotësuar nevojat e përfituesve të këtyre shërbimeve;



dh) “Ofrues i akredituar i aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror/në vijim ‘ofruesit’”, janë të gjitha strukturat, publike ose jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, që ka si objekt veprimtarie ofrimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e Republikës së Shqipërisë, të licencuar sipas legjislacionit në fuqi.

e) Çdo term tjetër i përdorur ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

3. Profesionisti i shërbimeve të përkujdesit shoqëror, subjekt i këtij vendimi, është punonjësi social dhe psikologu i punësuar me kohë të plotë apo të pjesshme pune në:

a) Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit në një njësi administrative të një bashkie;

b) Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në një bashki;

c) çdo strukturë tjetër të një njësie së vetëqeverisjes vendore, që ka detyrë funksionale menaxhimin e rasteve të individëve në nevojë për përkujdesje shoqërore; dhe

ç) një ofrues publik apo privat të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

4. Profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror (në vijim profesionisti) detyrohet t'i nënshtrohet edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar për të përmirësuar njohuritë, aftësitë dhe praktikën profesionale, me qëllim rritjen profesionale dhe të cilësisë së shërbimit që ofron. Edukimi i vazhdueshëm i profesionistit kryhet sipas programit të certifikimit për profesionistët e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

5. Programi i certifikimit zhvillohet në cikle pesëvjeçare certifikimi, në kuadër të edukimit të vazhdueshëm, i cili përputhet me afatet kohore të lejes së ushtrimit të profesionit/licencës.

6. Brenda çdo cikli të programit, profesionisti të ketë kryer aktivitete të edukimit të vazhdueshëm, nga të cilat të ketë mbledhur numrin minimal të detyrueshëm të krediteve, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim. Në përfundim të ciklit të programit të certifikimit çdo profesionist vlerësohet për përmbushjen e kritereve të certifikimit dhe merret vendimi përkatës.

7. Përynjatimisht, profesionistët, të cilët dalin në pension brenda periudhës pesëvjeçare të ciklit dhe që nuk do të vazhdojnë ta ushtrojnë profesionin e tyre, përjashtohen nga detyrimet e programit të certifikimit për atë cikël.

8. Profesionistët, të cilët gjatë një viti kalendarik të ciklit të programit ndërpresin punën për një periudhë katërmujore ose edhe më gjatë, përjashtohen nga kërkesat e programit për atë vit kalendarik.

II. PARIMET PËR PËRZGJEDHJEN E AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM

1. Profesionisti planifikon vetë pjesëmarrjen në aktivitete të edukimit të vazhdueshëm, bazuar në qëllimin e punës së tij profesionale, nevojat e identifikuar dhe kompetencat e dëshiruara.

2. Profesionisti zgjedh të marrë pjesë në ato aktivitete të edukimit të vazhdueshëm që bazohen në nevojat e perceptuara nga ai vetë, si dhe në ato që janë identifikuar nga vlerësime të tjera.

3. Aktiviteti i edukimit të vazhdueshëm i zgjedhur nga profesionisti të ketë lidhje me specialitetin, rolin profesional dhe përgjegjësitë që ka profesionisti në pozicionin përkatës të punës.

4. Profesionisti të jetë i angazhuar për të ruajtur profesionalizmin gjatë gjithë kohës së ushtrimit të profesionit dhe në kujdesin që ofron.

5. Profesionisti nxitet të integrojë procesin individual të të mësuarit në atë të ekipit me të cilin punon, grupe të kolegëve apo komunitetin e gjerë.

III. DETYRIMI I PUNËDHËNËSVE PËR TË MBËSHITETUR DHE LEHTËSUAR EDUKIMIN E VAZHDUESHËM TË PROFESIONISTIT

1. Institucioni publik dhe ofruesi publik apo jopublik, i shërbimit të përkujdesit shoqëror, në të cilin profesionisti është i punësuar, detyrohet të lehtësojë edukimin e vazhdueshëm të profesionistit, në mënyrë të veçantë institucioni apo ofruesi detyrohet të:

a) krijojë kushte dhe mundësi që profesionisti të përfshihet në aktivitete të edukimit të vazhdueshëm, në përputhje me nevojat e pozicionit të tij të punës;

b) nxisë përfshirjen e profesionistit në aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm dhe të përfshijë në kontratat individuale të punësimit kërkesat e programit të certifikimit për profesionistët;



c) hartojë plane institucionale, njëvjeçare ose shumëvjeçare, të zhvillimit profesional të punonjësve të tyre, në përputhje me nevojat individuale, por edhe institucionale;

ç) ofrojë drejtpërdrejtë aktivitete të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e tij, në mënyrë që ata të mbledhin deri në të paktën 30 për qind të numrit të detyrueshëm të krediteve për secilin cikël të programit.

IV. KRITERET E CERTIFIKIMIT

1. Për t'u certifikuar në përfundim të një cikli (që përkon me kohëzgjatjen e lejes së ushtrimit të profesionit lëshuar nga Urdhri përkatës), profesionisti të plotësojë këto kritere:

a) Të ketë mbledhur numrin minimal të detyrueshëm të krediteve, jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) kredite nga pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të vazhdueshëm, të lidhura drejtpërdrejt me punën e profesionistit, nga të cilat:

i. jo më pak se 50% të krediteve të jenë mbledhur nga aktivitete të edukimit të vazhdueshëm të akredituara për punonjësit social/psikologët;

ii. jo më shumë se 50% të krediteve të jenë mbledhur nga aktivitete të edukimit të vazhdueshëm në distancë, të akredituara; dhe

iii. jo më shumë 25% të jenë mbledhur nga aktivitete të edukimit në vazhdim, të zgjedhura lirisht, të vetëraportuara dhe dokumentuara nga profesionisti.

b) të ketë mbledhur jo më pak se 7 kredite në secilin vit të ciklit.

V. ADMINISTRIMI I PROCESIT TË CERTIFIKIMIT

1. Struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror është përgjegjëse për administrimin e procesit të certifikimit të profesionistëve, nën monitorimin e Bordit të Edukimit në Vazhdim. Struktura përgjegjëse për edukimin në vazhdim akreditohet sipas ISO/IEC 17024:2012.

2. Çdo profesionist detyrohet të regjistrohet në strukturën përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Procedurat e regjistrimit, sipas ligjit, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës të çështjeve sociale.

3. Që nga momenti i regjistrimit të një profesionisti, struktura përgjegjëse për edukimin e

vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror krijon dosjen profesionale të profesionistit, ku përfshihen të dhënat e identifikimit profesional, aktivitete të edukimit të vazhdueshëm dhe kreditet e përfituara për secilin cikël të programit të certifikimit dhe vendimet lidhur me certifikimin.

4. Struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror krijon dhe administron Regjistrin Kombëtar të Profesionistëve të Përkujdesit Shoqëror, që përbëhet nga dosjet profesionale.

VI. PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM DHE KREDITEVE PËRKATËSE

1. Çdo aktivitet i edukimit të vazhdueshëm i kryer nga profesionisti dhe kreditet përkatëse të mbledhura të jenë të regjistruara në dosjen e tij profesionale, në strukturën përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, që të merret në konsideratë për procesin e certifikimit të profesionistit.

2. Njohja dhe regjistrimi në dosjen profesionale të një profesionisti, i krediteve nga aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm të akredituar nga struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bëhet nga struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në bazë të njoftimit me shkrim nga ofruesi i aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm.

3. Në zbatim të pikës 3, të këtij kreu, ofruesi i aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm detyrohet të njoftojë në strukturën përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror listën e profesionistëve pjesëmarrës në çdo aktivitet, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i aktivitetit.

4. Njohja dhe regjistrimi në dosjen profesionale të një profesionisti, i krediteve nga aktivitete të edukimit të vazhdueshëm të akredituara nga një institucion tjetër, përveç strukturës përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bëhet nga struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, më kërkesë të vetë profesionistit.



5. Pika 4, e këtij kreu, zbatohet edhe për kreditet e mbledhura nga ndjekja e programeve të studimeve të formimit të vazhduar, programet e studimit të ciklit të dytë dhe ciklit të tretë.

6. Së bashku dhe si pjesë e kërkesës për regjistrim, sipas pikave 4 dhe 5, të këtij kreu, profesionisti të paraqesë programin e aktivitetit/programit dhe certifikatën apo diplomën e përfutur prej tij me numrin përkatës të krediteve.

7. Njohja dhe regjistrimi i krediteve në dosjen profesionale të një profesionisti, nga aktivitete të edukimit të vazhdueshëm dhe aktivitete të tjera që vetëraportohen, si botimet në revista shkencore, drejtimi i praktikave profesionale, pjesëmarrja në programet e multimedias, studimi i literaturës profesionale apo vizitat studimore, bëhet nga struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në bazë të kërkesës së vetë profesionistit.

8. Së bashku dhe si pjesë e kërkesës për regjistrim sipas pikës 7, të këtij kreu, profesionisti, të paraqesë edhe këto dokumente:

a) Në rastin e aktiviteteve konferencë shkencore, konferencë, trajnim *workshop*, prezantim leksioni, grup rishikimi - programin e aktivitetit dhe certifikata apo diploma përkatëse;

b) Në rastet e botimit të artikujve, kapitujve të librave ose librave - fotokopje të kapakut të revistës ose të librit, si dhe fotokopja e faqes së parë të artikullit ose të kapitullit;

c) Në rastet e hartimit të teksteve mësimore - vërtetim nga shtëpia botuese dhe një fotokopje e faqes së parë të tekstit;

ç) Në rastin e drejtimit të një praktike të studentëve - vërtetim nga fakulteti dhe ofruesi i shërbimit të kujdesit shoqëror ku është kryer praktika e studentit;

d) Në rastin e pjesëmarrjes në programet e multimedias - të dhëna për programin dhe deklarin e orëve të pjesëmarrjes;

dh) Në rastin e leximit të literaturës profesionale - një përmbledhje të detajuar të literaturës profesionale që ka studiuar;

e) Në rastin e një vizite studimore - programin e vizitës studimore ku është përfshirë.

9. Kërkesa për njohje dhe regjistrim të krediteve, sipas pikave 4, 5 dhe 7, të këtij kreu, së bashku me dokumentacionin shoqëruar, sipas pikave 6 dhe 8, të këtij kreu, të paraqitet në strukturën përgjegjëse për edukimin e

vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, jo me vonë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së përfundimit të çdo viti, të ciklit të certifikimit për profesionistin.

10. Vendimi për njohjen dhe regjistrimin e krediteve në dosjen profesionale të profesionistit apo përkatësisht refuzimin merret nga struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe i njoftohet profesionistit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e listës nga ofruesi i aktivitetit, sipas pikës 2, të këtij kreu, apo përkatësisht, nga paraqitja e kërkesës së plotë nga profesionisti, sipas pikave 4, 5 dhe 7, të këtij kreu.

11. Vendimi për njohjen dhe regjistrimin përcakton dhe numrin e krediteve për çdo veprimtari të njohur dhe të regjistruar.

12. Numri i krediteve, në rastin e parashikuar në pikën 2, të këtij kreu, është numri i krediteve të përcaktuara nga ofruesi i aktivitetit të vazhdueshëm në përputhje me pjesëmarrjen konkrete të profesionistit. Ndërsa në rastin kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në këto aktivitete, numri i krediteve llogaritet nga struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në bazë të kohëzgjatjes efektive të leksionit, sipas kriterit 1 (një) orë leksion e barabartë me 2 (dy) kredite.

13. Përcaktimi i numrit të krediteve për aktivitetet në rastin e parashikuar në pikën 5, të këtij kreu, bëhet sipas rregullit 1 (një) kredit i studimeve të larta është i barabartë me 25 (njëzet e pesë) kredite të edukimit të vazhdueshëm.

14. Vlerësimi për përcaktimin e numrit të krediteve për aktivitetet e parashikuara në pikën 7, të këtij kreu, bëhet nga struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas skemës së përlllogaritjes së krediteve, të parashikuara në aneksin nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

15. I gjithë dokumentacioni i programit të certifikimit ruhet nga struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

VII. PROCEDURA E CERTIFIKIMIT

1. Në përfundim të ciklit të certifikimit, për çdo profesionist, struktura përgjegjëse për edukimin e



vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, kryesisht, shqyrton dhe vlerëson përmbushjen e kritereve të ciklit të programit të certifikimit, si dhe vendos për certifikimin e profesionistit apo refuzimin e certifikimit.

2. Vendimi, sipas pikës 1, të këtij kreu, merret dhe i njoftohet profesionistit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbarimi i ciklit të certifikimit. Dispozitivi i vendimit i njoftohet, gjithashtu, brenda të njëjtit afat, edhe institucionit apo ofruesit të shërbimit publik apo privat ku është i punësuar profesionisti.

3. Lista e profesionistëve të certifikuar bëhet publike nga struktura përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, nëpërmjet shpalljes në faqen zyrtare elektronike të institucionit.

VIII. ANKIMI

1. Ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të strukturës përgjegjëse për edukimin e vazhdueshëm

të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, lidhur me certifikimin e profesionistit apo refuzimin e certifikimit, sipas këtij vendimi, mund të bëhet ankim administrativ.

2. Ankimi paraqitet dhe shqyrtohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm është “organi epror” në procedurën e shqyrtimit të ankimit administrativ, sipas kuptimit të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Afati për shqyrtimin e ankimit dhe njoftimin e vendimit është 30 (tridhjetë) ditë nga paraqitja e ankesës.

Ky vendim hyn në fuqi 1 (një) vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Erion Braçe

ANEKSI NR. 1

KREDITET PËR AKTIVITETET E EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM

NR.	EMËRTIMI I AKTIVITETIT	KREDITET
1	Konferenca shkencore	1 orë = 1.5 kredit (përlogaritja kryhet duke shmangur kohën e pushimeve, hapjes dhe mbylljes së aktivitetit)
2	Konferencë (maksimumi 3 ditë)	1 orë = 1 kredite (përlogaritja kryhet duke shmangur kohën e pushimeve, hapjes dhe mbylljes së aktivitetit)
3	Trajnimi (1 ditë deri në 3 muaj)	1 orë = 0.5 kredite (përlogaritja kryhet duke shmangur kohën e pushimeve, hapjes dhe mbylljes së aktivitetit)
4	<i>Workshop</i> (1–2 ditë)	1 orë = 0.5 kredite (përlogaritja kryhet duke shmangur kohën e pushimeve, hapjes dhe mbylljes së aktivitetit)
5	Prezantim leksioni (maksimumi 2 orë)	1 orë = 1 kredit
6	Grup rishikimi (1–2 orë)	1 orë = 1 kredite
7	Edukim në distancë	3 kredite në ditë
9	Botim në Revistë shkencore e indeksuar në regjistër ndërkombëtar dhe me faktor impakti	3 kredite në rastin e bashkautorësisë 20 kredite kur është autor
10	Botim në Revistë shkencore e indeksuar në regjistër ndërkombëtar pa faktor impakti	2 kredite nëse është bashkautor 15 kredite nëse është autor
11	Botim në Revistë shkencore e paindeksuar në regjistër ndërkombëtar dhe pa faktor impakti	1 kredit nëse është bashkautor 7 kredite nëse është autor
12	Bashkautor ose autor teksti mësimor	15 kredite nëse është bashkautor 50 kredite nëse është autor
13	Lexim artikulli shkencor	0.1 kredite
14	Lexim libri shkencor	0.5 kredite
15	Drejtim praktike profesionale	1 kredit për 3 student
16	Vizita studimore (brenda dhe jashtë vendit)	0.5 kredite në ditë



VENDIM

Nr. 625, datë 29.7.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 407, DATË 8.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NJË REGJIMI KONTROLLI PËR TË GARANTUAR RESPEKTIMIN E RREGULLAVE TË POLITIKAVE MENAXHUESE NË PESHKIM”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 72, pika 8, 74, pika 3, 82, pika 2, 101, pika 2, pika 3, 113, pika 1, 116, 118, pika 3, dhe 135, pika 1, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 33, të vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 33/1, me këtë përmbajtje:

“33/1. Pajisja MTU (*Mobile Transceiver Unit*), për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, jepet falas nga ministria deri më 31 dhjetor 2020, për të gjitha anijet mbi 12 metër, të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit.

Fondi për blerjen e pajisjes që jepet falas përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2020.”

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 626, datë 29.7.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 488, DATË 17.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPËRNDARJEN DHE DETAJIMIN E FONDIT PREJ 950 295 959 LEKËSH, NË PROGRAMIN ‘MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 488, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në titull, shifra: “... 950 295 959 ...” zëvendësohet me: “... 1 050 295 959 ...”.

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1 050 295 959 (një miliard e pesëdhjetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë, në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”, për projektet e ujitjes, sigurinë e digave dhe mbrojtjes nga përmytja, sipas bashkive, përcaktuar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.”

c) Tabela bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Tabela - Lista e projekteve

Nr.	Institucioni përfitues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit në lekë	Financimi për vitin 2020	Financimi i parashikuar për vitin 2021
		Totali	1,719,614,137	1,050,295,959	669,318,177
		Objekte në vazhdim <i>(Financuar pjesërisht gjatë vitit 2019, me VKM-në nr. 170, datë 27.3.2019, "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1 000 000 000 (një miliard) lekë në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit", të ndryshuar)</i>	639,598,930	639,598,930	0
		<i>Projekte për rehabilitimin e digave</i>		191,685,054	0
1	Bashkia Krujë	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Tapizë		24,444,551	
2	Bashkia Mat	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shoshaj		22,953,070	
3	Bashkia Roskovec	Rehabilitim i ujëmbledhësit Kuçan		10,352,335	
4	Bashkia Kamzë	Rezervuari Paskuçan		38,865,896	
5	Bashkia Pukë	Rehabilitimi i digës së rezervuarit Kukaj		19,069,255	
6	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Arapaj 1		29,945,787	
7	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Spitalë		20,054,160	
8	Bashkia Rrogozhinë	Rehabilitimi i digës dhe skemës ujëtare të rezervuarit të Okshunit		26,000,000	
		<i>Projekte për infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmblytja</i>		447,913,876	0
1	Bashkia Elbasan	Përroi i Zaranikës		86,495,097	
2	Bashkia Fier	Dega Ujitëse e Fierit		8,930,576	
3	Bashkia Divjakë	Skema ujitëse-Sektorin i Ri në Xëng		41,861,325	
4	Bashkia Kolonjë	Kanali ujitës Kabash, Leskovik		4,941,538	
5	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i pjesshëm i Degës Ventrok		7,918,633	
6	Bashkia Mirditë	Rehabilitim i skemës ujëtare, ujëmbledhësi Malaj-2 (Faza 3)		27,212,647	
7	Bashkia Malësi e Madhe	Skemë ujëtare me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shtodrit, Loti 2		11,482,904	
8	Bashkia Pukë	Rehabilitimi i kanalit vaditës, fshati Qerret		8,784,266	
9	Bashkia Shijak	Rehabilitimi i kanalit ujitës, Hardhishtë-Rreth		38,229,893	
10	Bashkia Belsh	Kanali i Ujitjes Çerragë		23,278,603	
11	Bashkia Gramsh	Rikonstruksion i kanalit ujitës Galigat-Cingar Sipër-Drizë		14,081,687	
12	Bashkia Librazhd	Rikonstruksion i kanalit vaditës Gurakuq Kuturman, (Loti I, ndërtimi i Sifonit të Madh)		16,627,253	
13	Bashkia Këlcyrë	Skema Ujitëse Ballaban, ujitja e fushës Ballaban, vazhdim		17,385,008	
14	Bashkia Bulqizë	Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Vija e Mullitit, Gjonice		22,800,328	
15	Bashkia Dibër	Kanali ujitës Përroi i Lixhave, lagja Dobrovë		5,787,096	
16	Bashkia Dibër	Sifoni ujitës, dalja e rezervuarit Shumbat		6,633,317	
17	Bashkia Kukës	Rehabilitim i kanalit ujitës Bushat, Njësia Administrative Bicaj, Bashkia Kukës		4,684,253	
18	Bashkia Roskovec	Rehabilitimi i pesë kanaleve ujëtare në zonën e Sukut		35,240,203	
19	Bashkia Lushnjë	Rehabilitimi i kanalit ujitës U.3-15, U.3-15/4, U.3-15/5, në fshatin Fier i Ri, Nj. Ad. Krutje		2,895,288	
20	Bashkia Ura Vajguore	Kanali ujitës BRU-15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit		7,714,000	
21	Bashkia Cërrik	Rehabilitim sistemi ujitës		12,947,338	
22	Bashkia Fushë-Arrëz	Rikonstruksion i kanalit, fshati Iballë		14,761,955	
23	Bashkia Përmes	Kanali Strëmbec		7,044,828	
24	Bashkia Libohovë	Rehabilitimi i skemës ujëtare të Bulos, si dhe kanalit kullues K-1-76, Fushë Nepravishhtë		19,334,085	
25	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier	Mbrojtje nga Lumi Vjosë, në Kashisht		185,637	
26	Bashkia Vlorë	Kanali Ujitës VLU-10		656,118	
		Objekte të reja	1,080,015,206	410,697,029	669,318,177
		<i>Projekte për rehabilitimin e digave</i>	195,380,297	57,305,489	138,074,808
1	Bashkia Dibër	Rehabilitimi i Digës së Gramës	56,911,841	13,000,000	43,911,841
2	Bashkia Shijak	Ndërtimi i shkarkuesve katastrofik në rezervuar	3,231,733	3,231,733	
3	Bashkia Kamzë	Rehabilitimi i Digës së Rezervuarit Paskuçan (faza e dytë)	52,462,000	12,000,000	40,462,000
4	Bashkia Dropull	Rehabilitimi i digave të ujëmbledhësve të Bashkisë Dropull (Kakavijë, Likomil, Peshkëpi dhe Bodrishtë) dhe i kanalit ujitës të rezervuarit të Peshkëpisë	35,927,723	14,073,756	21,853,967
5	Bashkia Tiranë	Rehabilitim i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonje	46,847,000	15,000,000	31,847,000
		<i>Projekte për infrastrukturën e ujitjes</i>	884,634,909	353,391,540	531,243,369
1	Bashkia Tepelenë	Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj	21,600,000	10,000,000	11,600,000
2	Bashkia Sarandë	Rehabilitimi i kanalit ujitës Ksamil, pjesa e I	32,858,207	10,000,000	22,858,207
3	Bashkia Mallakastër	Rehabilitimi i rrjetit ujitës Çorrush	35,006,071	11,000,000	24,006,071
4	Bashkia Fier	Dega e Martinës	40,966,000	10,000,000	30,966,000
5	Bashkia Vau i Dejës	Ku-13, Shelqet, Vau i Dejës	13,740,541	10,000,000	3,740,541
6	Bashkia Klos	Rikonstruksion, kanali vaditës Cerujë	3,736,400	3,736,400	
7	Bashkia Selenicë	Rehabilitim i kanalit vaditës, rezervuari Harvala, rikonstruksioni i kanalit në pjesën e parë nga dalja e ujëlshuesit të rezervuarit, deri në progresivin 1800 ml	22,137,547	10,000,000	12,137,547
8	Bashkia Shijak	Rehabilitimi i sistemit ujitës, Nj. A. Gjeplaj	14,983,766	10,000,000	4,983,766



9	Bashkia Devoll	Pellgu ujëmbledhës, kanali i furnizimit me ujë të rezervuarit në qytetin e Bilishtit	26,792,502	10,000,000	16,792,502
10	Bashkia Skrapar	Mbrojtje nga lumi Guak në krahun e majtë, në zonën Veronit, Çorovodë	22,963,658	22,963,658	-
11	Bashkia Lezhë	Kanali ujitës Kotër–Rraboht, segmenti Kotër–Nënshat (L=1000m) dhe segmenti Pirraj–Rraboht (L=2150m)	46,199,992	15,000,000	31,199,992
12	Bashkia Librazhd	Rikonstruksion i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz, Librazhd	62,179,787	19,200,600	42,979,187
13	Bashkia Përmët	Ndërtim i rrjetit ujitës Bodar–Kutal	26,559,105	10,000,000	16,559,105
14	Bashkia Lushnjë	Rehabilitimi i kanalit ujitës U3-27, V-1/1 në fshatin Bishtqethën dhe Bitaj, Nj. A. Kolonjë	28,597,408	10,000,000	18,597,408
15	Bashkia Gjirokastrë	Rikonstruksion i kanalit vaditës Zhulat	67,638,000	15,220,756	52,417,244
16	Bashkia Bulqizë	Kanali ujitës Tuçep, Bulqizë	129,746,000	27,000,000	102,746,000
17	Bashkia Cërrik	Rehabilitimi i kanaleve vaditëse e kulluese, Bashkia Cërrik	41,200,000	12,000,000	29,200,000
18	Bashkia Kolonjë	Rikonstruksion i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë	75,894,848	21,000,000	54,894,848
19	Bashkia Përrenjas	Rehabilitimi i skemës ujitëse Radigos–Stranik–Berzeshtë	73,564,951	18,000,000	55,564,951
20	Bashkia Rrogozhinë	Rehabilitimi i kanaleve sekondare Peqin–Kavajë, faza e tretë	98,270,126	98,270,126	

VENDIM**Nr. 627, datë 29.7.2020**

**PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË
BILETAVE TË TEATRIT KOMBËTAR
TË OPERËS, BALETIT DHE
ANSAMBLIT POPULLOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së biletave për Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e masës së reduktimit në tarifën e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Masa e reduktimit nuk aplikohet për biletat e premierave.

3. Të ardhurat e realizuara nga shitja e biletave të përdoren:

- 30% për llogari të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, sipas limitit të përcaktuar në planin e shpenzimeve;
- 70% derdhen në buxhetin e shtetit.

4. Në asnjë rast, këto të ardhura nuk do të përdoren për shpërbimin e punonjësve.

5. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

SHTOJCA NR. 1

**ÇMIMET E BILETAVE TË TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE
ANSAMBLIT POPULLOR**

Kategoria	Vendndodhja në auditorium	Kapaciteti	Opera/ gala/ musical		Balet/ opereta		Shfaqje ekskluzive/ koncerte	
			premierë	repertor	premierë	repertor	premierë	repertor
A	Lozhat qendrore	32	2,500	2,000	2,000	1,500	1,500	1,000
B	Plateja 7–16	320	2,000	1,500	1,200	1,000	1,000	800
	Lozhat anësore	16	2,000	1,500	1,200	1,000	1,000	800
C	Plateja 1–6	190	1,200	1,000	1,000	800	800	500
	Galeria	242	1,200	1,000	1,000	800	800	500
	Holli, kati II	100					500	500
Teatri për fëmijë				500		400		300



SHTOJCA NR. 2
REDUKTIMIT E BILETAVE BAZUAR NË KATEGORITË SOCIALE

Kategoria	Masa e reduktimit në %, në raport me tarifat bazë të biletave
Pensionistët	25%
Invalidët e punës	50%
Paraplegjik/tetraplegjik	50%
Jetimët	50%
Studentët	50%
Fëmijë (mosha 6–18 vjeç)	50%
Të verbrit	100% (hyrja falas)

VENDIM
Nr. 628, datë 29.7.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE “CARITAS
SHQIPTAR”, PËR BASHKËPUNIM NË
FUSHËN E NDËRTIMIT TË BANESAVE
PAS FATKEQËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20, të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore’”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe “Caritas Shqiptar”, për bashkëpunim në fushën e ndërtimit të banesave pas fatkeqësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Autorizimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe bashkitë Lezhë, Kurbin dhe Belsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Nr. Prot Nr. Prot Tiranë __.__.2020

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
DHE “CARITAS SHQIPTAR” PËR
BASHKËPUNIM NË FUSHËN E
NDËRTIMIT TË BANESAVE PAS
FATKEQËSISË**

Sot, në datën . . 2020, lidhet kjo marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe “Caritas Shqiptar” (shoqatë jofitimprurëse), me seli ligjore në Tiranë në rr. “Don Bosko”, e njohur dhe regjistruar si person juridik, në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 6415, datë 3.10.1995, si dhe me ndryshimet e tjera përkatëse të depozituara në regjistrin e OJF-ve të kësaj Gjykate, i përfaqësuar nga Atë Antonio Leuci, përfaqësues ligjor (Drejtor Kombëtar), banues për shkak të misionit në Shënkoll, Lezhë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i referuar më poshtë si “Donatori”, të cilëve bashkërisht iu referohet si “Palët”, dhe secilit prej tyre si “Pala”.

Duke qenë se:

A. Në mëngjesin e datës 26 nëntor 2019, në Shqipëri u regjistrua një ndër tërmetet më të fuqishëm të dekadave të fundit, nga i cili u dëmtuan rëndë qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë. Për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, dhe me vendimin nr. 751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, është përfshirë dhe qarku Lezhë.



B. Ligji nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ka përcaktuar kuadrin e nevojshëm ligjor, organet përgjegjëse, si dhe një sërë masash që do të mundësojnë rimëkëmbjen e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, ku ndër të tjera ka përcaktuar mundësinë e palëve të treta të cilat nëpërmjet donacioneve, të kontribuojnë në funksion të përballimit të këtyre pasojave.

C. Në përgjigje të kërkesave për mbështetje të qeverisë së Republikës së Shqipërisë janë solidarizuar edhe shumë shoqëri tregtare, organizata të ndryshme joqeveritare, individë, vendës ose të huaj, të cilët kanë shprehur vullnetin për të ofruar donacione të natyrave të ndryshme, në ndihmë të procesit të rindërtimit dhe të zhvillimit të zonave të reja të shpallura.

D. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi rregullon parimet themelore për realizimin e projektit (referuar në vijim si “Projekti”), të përbërë nga dy programe me qëllim përballimin e nevojës urgjente për strehim në zonat e prekura nga tërmeti që goditi Shqipërinë më datë 26 nëntor 2019:

- Programi i mbështetjes cash “Multi purpose cash” për 334 familje të prekura nga tërmeti;
- Programi i rindërtimit dhe rikonstruksionit të 100 njësive të banimit.

Palët, në referim të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, bien dakord si më poshtë vijon.

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1.1 Objekt i kësaj marrëveshjeje është realizimi i Projektit, të përbërë nga dy programe:

- Programi i mbështetjes cash “Multi purpose cash” për 334 familje të prekura nga tërmeti, sipas listës së përfituesve që do t’i vihet në dispozicion Donatorit nga bashkitë përfituese;
- Programi i ndërtimit, për:

I. Rikonstruksion i lehtë i 30-të njësive të banimit;

II. Rikonstruksion i rëndë i 30-të njësive të banimit;

III. Rindërtim i 40-të njësive të banimit,

sipas propozimit të Donatorit dhe bazuar në kërkesës për nevojë dhe listave të përfituesve të bashkive përfituese Lezhë, Kurbin dhe Belsh, bazuar në kushtet teknike të pranuar nga Palët dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

1.2 Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, zbatimi i këtij Projektit do të bëhet nga Donatori dhe do të monitorohet nga bashkitë përfituese.

Neni 2

Masa e donacionit

2.1 Masa e donacionit, sipas kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, do të detajohet si më poshtë:

a) Programi i mbështetjes cash (si mbështetje e 334 familjeve të prekura nga tërmeti, të cilët do të përfitojnë 4 transferta, ku vlera e një transferte do të jetë në masën 15 531 (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë.

b) Programi i ndërtimit, për:

I. Rikonstruksion i lehtë i 30-të njësive të banimit, në vlerën maksimale 400 000 (katërqind mijë) lekë/shtëpi

II. Rikonstruksion i rëndë i 30-të njësive të banimit, në vlerën maksimale 800 000 (tetëqind mijë) lekë/shtëpi;

III. Rindërtim i 40 njësive të banimit, në vlerën maksimale 2 400 000 (dy milion e katërqind mijë) lekë/shtëpi.

2.2 Donacioni, sipas kësaj marrëveshjeje, do t’u nënshtrohet parashikimeve ligjore në fuqi për përjashtimet fiskale përkatëse, në rastet e fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 3

Detyrimet e palëve

3.1 Midis Donatorit dhe bashkive përfituese do të lidhet marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit, me qëllim zbatimin e të dyja programeve të parashikuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.2 Lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit programi i ndërtimit do të nxirren nga autoritetet përgjegjëse në bashkëpunimit me bashkitë përfituese të Projektit

3.3 Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998,



“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 354, datë 11.5.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, për programin e ndërtimit do të realizohen nga bashkitë përfituese.

3.4 Kontraktorët, nënkontraktorët dhe konsulentët për realizimin e Projektit do të përzgjidhen nga Donatori.

3.5 Bashkitë përfituese do të marrin përsipër të garantojnë vendosjen në dispozicion të Donatorit të sheshit të ndërtimit, si dhe të gjithë dokumentacionit të nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për realizimin e Projektit.

3.6 Në lidhje me parcelat, truallin ku do të kryhen punimet, dorëzimi i shesheve të ndërtimit do të bëhet nga bashkitë përfituese. Të gjitha lejet e nevojshme, me qëllim realizimin e këtij Projekti, do të sigurohen nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar, nëpërmjet bashkive përfituese.

3.7 Monitorimi i zbatimit të Projektit do të bëhet nga bashkitë përfituese.

3.8 Donatori, sipas kësaj marrëveshjeje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve të legjislacionit fiskal, në kuadër të procesit të rindërtimit.

3.9 Në përfundim të realizimit të Projektit, Donatori u përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të Projektit bashkive përfituese.

3.10 Të gjitha procedurat (veprimet) përfundimtare të pranimit të Projektit, do të kryen nga bashkitë përfituese, në përputhje me aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Njoftimet dhe komunikimet

4.1 Çdo njoftim që do t'i jepet një Pale dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë kontratë do të bëhet me shkrim dhe do t'i dërgohet dorazi ose me postë rekomande në adresat e mëposhtme:

“Caritas Shqiptar”

Adresa: Rruga “Don Bosko”, nr. 4, Tiranë

Email: caritasalbania@caritasalbania.org

Tel.: ++355 4 22 30088 Fax: ++355 4 22 34327

Çdo njoftim ndaj pranuesit të donacionit do të adresohet te:

Ministri i Shtetit për Rindërtimin

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë

<https://rindertimi.gov.al/>

Email: Sekretariati.Rindertimi@kryeministria.al

Çdo ndryshim i adresës i njëres Palë do duhet t'i njoftohet me shkrim Palës tjetër.

Neni 5

Ndryshimet

5.1 Çdo ndryshim i rregullimeve apo i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me një amendament të kësaj marrëveshjeje, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të Palëve.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhen me bisedime mes Palëve, në kuadër të vullnetit të mirë.

Neni 7

Konfidencialiteti

7.1 Informacionin, dokumentacionin dhe plan-projektet që Palët do të shkëmbejnë me njëra-tjetrën, në lidhje me realizimin e Projektit, do t'i përdorin vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe nuk do t'i transferojnë ato te një palë e tretë, pa marrë pëlqimin me shkrim të Palës që i ka siguruar ato.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

8.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme deri në realizimin e objektit.

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi nuk do të ndikojë në projektet dhe në aktivitetet në vazhdim ose të përfunduara.



Për sa më sipër, të nënshkruarit, kanë nënshkruar kontratën në 4 (katër) origjinale.

Nënshkruar në Tiranë,
më 2020

Nënshkruar në Tiranë,
më 2020

**MINISTRI I SHETITIT
PËR RINDËRTIMIN**
Arben Ahmetaj

CARITAS SHQIPTAR
Atë Antonio Leuci
Drejtor

VENDIM

Nr. 630, datë 29.7.2020

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS BAMIRËSE “JETIMËT E BALLKANIT” PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E NDËRTIMIT TË BANESAVE PAS FATKEQËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20, të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore’”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqatës bamirëse “Jetimët e Ballkanit”, për bashkëpunim në fushën e ndërtimit të banesave pas fatkeqësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Autorizimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

Nr. Prot Tiranë më, .., .., 2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE SHOQATËS BAMIRËSE “JETIMËT E BALLKANIT” PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E NDËRTIMIT TË BANESAVE PAS FATKEQËSISË

Sot, në datën . . 2020, lidhet kjo marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqatës bamirëse “Jetimët e Ballkanit”, regjistruar në Regjistrin e Organizatave Joqeveritare në Republikën e Kosovës, me nr. regjistrimi 5112584-3, datë 23.10.2009, me numër fiskal 600322200, me përfaqësues të autorizuar z. Berat Kabashi, referuar më poshtë si “Donatori”, të cilëve bashkërisht iu referohet si “Palët” dhe secilit prej tyre si “Pala”.

Duke qenë se:

A. Në mëngjesin e datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri u regjistrua një ndër tërmetet më të fuqishëm të dekadave të fundit, nga i cili u dëmtuan rëndë qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë. Për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, dhe me vendimin nr. 751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, është përfshirë dhe qarqet Lezhë.

B. Ligji nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore’”, ka përcaktuar kuadrin e nevojshëm ligjor, organet përgjegjëse, si dhe një sërë masash që do të mundësojnë rimëkëmbjen e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, ku ndër të tjera ka përcaktuar mundësinë e palëve të treta, të cilat nëpërmjet donacioneve, të kontribuojnë në funksion të përballimit të këtyre pasojave.

C. Në përgjigje të kërkesave për mbështetje të qeverisë së Republikës së Shqipërisë janë solidarizuar edhe shumë shoqëri tregtare, organizata të ndryshme joqeveritare, individë, vendës ose të huaj, të cilët kanë shprehur vullnetin për të ofruar donacione të natyrave të ndryshme në



natyrë, në ndihmë të procesit të rindërtimit dhe të zhvillimit të zonave të reja të shpallura.

D. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi rregullon parimet themelore për realizimin e Projektit, për ndërtimin e 26 (njëzet e gjashtë) apartamenteve dhe 9 (nëntë) banesave individuale, në Bashkinë Lezhë, në masën prej 891 104 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e katër) euro (referuar në vijim si “Projekt”), sipas kushteve teknike të pranuar nga Palët dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

Palët, në referim të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, bien dakord, si më poshtë vijon.

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1.1 Objekt i kësaj marrëveshjeje është realizimi i punime për ndërtimin e 26 (njëzet e gjashtë) apartamenteve dhe 9 (nëntë) banesave individuale, në Bashkinë Lezhë, si edhe infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e tyre dhe të komuniteteve ku do të vendosen.

1.2 Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, detyrën e njësisë zbatuese do ta kryejë Bashkia Lezhë.

Neni 2

Masa e donacionit

2.1 Masa e donacionit, sipas kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, është në vlerën 891 104 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e katër) euro.

2.2 Donacioni, sipas kësaj marrëveshjeje, do t’u nënshtrohet të gjitha parashikimeve ligjore në fuqi për përjashtimet fiskale përkatëse, në rastet e fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 3

Detyrimet e palëve

3.1 Bashkia Lezhë, në rolin e njësisë zbatuese, do t’i garantojë donatorit një truall të përshtatshëm me sipërfaqe të mjaftueshme, në kuadër të zbatimit të Projektit.

3.2 Projektet e zbatimit për objektin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit do të hartohen nga Donatori, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, do të miratohen nga Palët me konsensus të përbashkët. Kostoja e ndërtimit të banesave dhe vlera e Projektit do të llogaritet duke marrë për bazë projektet e miratuara.

3.3 Lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit do të nxirren nga autoritetet përgjegjëse në bashkëpunimit me njësinë zbatuese.

3.4 Normat e projektimit dhe të zbatimit për ndërtimet do të jenë sipas standardeve të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, si dhe të konfirmuara me certifikatën CE.

3.5 Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 354, datë 11.5.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të bëhet nga njësia zbatuese.

3.6 Kontraktorët, nënkontraktorët dhe konsulentët për realizimin e Projektit do të përzgjidhen nga Donatori.

3.7 Njësia zbatuese do të marrë përsipër të garantojë vendosjen në dispozicion të Donatorit të sheshit të ndërtimit, si dhe të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për realizimin e Projektit.

3.8 Në lidhje me parcelat, truallin ku do të kryhen punimet, dorëzimi i shesheve të ndërtimit do të bëhet nga njësia zbatuese. Të gjitha lejet e nevojshme, me qëllim realizimin e këtij Projekti, do të sigurohen nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar, nëpërmjet njësisë zbatuese.

3.9 Të gjitha përgjegjësitë që kanë të bëjnë me palët e treta, që gjenden brenda sheshit të ndërtimit (shpronësimi, nxjerrja e njerëzve nga godinat në përdorim, shembja e objekteve, të gjitha përgjegjësitë ligjore ndaj personave që detyrohen të dalin nga sheshi i ndërtimit, si pasojë e zbatimit të Projektit) i takojnë njësisë zbatuese.

3.10 Donatori, sipas kësaj marrëveshjeje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve të legjislacionit fiskal në kuadër të procesit të rindërtimit.



3.11 Infrastrukturat brenda kufijve të Projektit do të bëhet nga Donatori dhe kontraktorët e përzgjedhur prej tij, ndërsa ndërtimi i lidhjeve me energji elektrike, furnizimi me ujë, kanalizimet e ujërave të zeza të nevojshme deri në kufijtë e sheshit të Projektit, do të sigurohen nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet njësisë zbatuese.

3.12 Në përfundim të realizimit të Projektit, Donatori përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të Projektit të realizuar dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave, i cili me vendim i kalon objektet e reja në pronësi të njësisë zbatuese, Bashkia Lezhë.

3.13 Të gjitha procedurat (veprimet) përfundimtare të pranimit të Projektit do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi nga njësisë zbatuese.

3.14 Donatori, sipas kësaj marrëveshjeje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve të legjislacionit fiskal në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 4

Njoftimet dhe komunikimet

4.1 Çdo njoftim që do t'i jepet një Pale dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë kontratë do të bëhet me shkrim. Çdo ndryshim i adresës së njëres Palë do të duhet t'i njoftohet me shkrim Palës tjetër.

Neni 5

Ndryshimet

5.1 Çdo ndryshim i rregullimeve apo i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me një amendament të kësaj marrëveshjeje, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të Palëve.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhen me bisedime mes Palëve në kuadër të vullnetit të mirë.

Neni 7

Konfidencialiteti

7.1 Informacionin, dokumentacionin dhe plan-projektet që Palët do të shkëmbejnë me njëra-tjetrën, në lidhje me realizimin e Projektit, do t'i përdorin vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe nuk do t'i transferojnë ato te një palë e tretë pa marrë pëlqimin me shkrim të Palës që i ka siguruar ato.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

8.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme deri në realizimin e objektit.

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi nuk do të ndikojë në projektet dhe aktivitetet në vazhdim ose të përfunduara.

Për sa më sipër, të nënshkruarit kanë nënshkruar kontratën në 4 (katër) origjinale.

Nënshkruar në Tiranë,
më2020

Nënshkruar në Tiranë,
më 2020

MINISTRI I SHTETIT PËR
RINDËRTIMIN
Arben Ahmetaj

DONATOR
SHOQATA BAMIRËSE
"JETIMËT E
BALLKANIT"
Z. Halil Kastrati

VENDIM

Nr. 632, datë 29.7.2020

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të ligjit nr. 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (në vijim DPSHMZSH), si person juridik, publik, me status të veçantë, në varësi të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike (në vijim ministri), me seli në Tiranë.

2. DPSHMZSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, si pjesë e buxhetit të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, të ardhurat nga shërbimi ndaj të tretëve, si dhe burime të tjera të ligjshme.

3. Misioni i DPSHMZSH-së, në cilësinë e autoritetit më të lartë teknik, mbikëqyrës dhe drejtues të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, është të garantojë shmangien e fillimit të një zjarri dhe ngjarjet që lidhen me të ose kufizimin e pasojave të tij apo fatkeqësive të tjera, nëpërmjet promovimit të rregullave, metodave të veprimit, monitorimit, koordinimit dhe trajnimit.

4. DPSHMZSH-ja ka këto përgjegjësi:

a) të organizojë punën për realizimin e funksioneve që lidhen me promovimin e rregullave, të metodave të veprimit, të monitorimit, të koordinimit;

b) të organizojë punën për realizimin e funksioneve që lidhen me kualifikimin dhe trajnimin e personelit të shërbimit vendor të MZSH-së, të personelit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të objekteve me rëndësi ekonomike dhe strategjike, dhe të shërbimit vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin;

c) të organizojë punën për funksione që lidhen me inspektimin.

5. DPSHMZSH-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

6. DPSHMZSH-ja kryen detyrat e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin apo legjislacion tjetër të lidhur me fushën e saj të përgjegjësisë dhe raporton e përgjigjet para ministrit.

7. DPSHMZSH-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili përfaqëson, organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet para ministrit.

8. DPSHMZSH-ja, për realizimin e misionit të saj, ushtrimin e funksioneve dhe realizimin e detyrave bashkëpunon me kryetarin e bashkisë, si dhe me institucionet e tjera të administratës publike, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

9. Organika dhe struktura e DPSHMZSH-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

10. Statusi i punonjësit të DPSHMZSH-së rregullohet:

a) sipas ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, për punonjësit me grada;

b) sipas Kodit të Punës, për punonjësit administrativ;

c) sipas legjislacionit, për nëpunësin civil.

11. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të DPSHMZSH-së miratohet nga ministri, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të DPSHMZSH-së.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ka stemën e saj, që përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet, “Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Për punonjësit aktual me grada të DPSHMZSH-së në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Brendshme, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Për nëpunësit civil aktual të DPSHMZSH-së në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Brendshme, zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil, në rastin e mbyljes dhe të ristrukturimit të institucionit.



15. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 637, datë 29.7.2020

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I RRUGËS QË LIDH
RRUGËN ‘TISH DAIA’ ME RRUGËN
‘ROBERT SHVARC’, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ‘Tish Daia’ me rrugën ‘Robert Shvarc’, Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë 89 584 546 (tetëdhjetë e nëntë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 89 584 546 (tetëdhjetë e nëntë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe të përfundojë brenda tre muajve pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë si dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTI “NDËRTIMI I RRUGËS QË LIDH RRUGËN ‘TISH DAIA’ ME RRUGËN ‘ROBERT SHVARC’, TIRANË

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Pjesa takuese	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. truall (m ²)	Sip. e prekur, truall (m ²)	Çmimi për truall (lek/m ²)	Vlera, truall i prekur (lek)	Sip. e gjurmës së objektit, sipas kartelës (m ²)	Sip. e përgj. ndërtimi e objektit, sipas kartelës (m ²)	Sip. e prekur, objekt (m ²)		Çmimi për objekt banimi (lek/m ²)	Vlera e sip. së prekur, objekt shërbimi, me situacion (lek)	Vlera e sip. së prekur objekt banimi (lek/m ²)	Vlera e përgj. truall + objekt (lek)	Konfirmim nga ASHK-ja Tiranë	Shënime
											Sip. shërbimi (m ²)	Sip. banimi (m ²)						
1	BP Vorpsi, Kika, Dalipi (Arjeta Muharrem Dalipi, Sadete Shaban Kika, Lirie Qazim Lika, Vjollca Vorpsi, Bardhyl Kika, Avenir Kika, Halil Qazim Kika, Afërdita Qazim Vorpsi, Alda Kujtim Kika, Flutura Qazim Kika, Klejda Kujtim Kika, Lulëzim Qazim Kika, Sokol Muharrem Kika, Vera Kika)	24/216, 24/216, 12/216, 12/216, 24/216, 24/216, 12/216, 12/216, 8/216, 12/216, 8/216, 12/216, 24/216, 8/216	8260	6/739	66.8	66.8	30783	2056304.40								2,056,304	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug	
2	Afërdita Qazim Vorpsi		8260	6/731	526.58	80	30783.0	2462640								2,462,640	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/3, datë 9.7.2019, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug	
3	Liri Qazim Kika		8260	6/351	250	3	30783	92349								92,349	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019 të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug	
10	Petrit Shkurt Çullhaj, Faik Shkurt Çullhaj		8260	4/753	100	10	30783	307830								307,830	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug	
11	Afërdita Qazim Vorpsi		8260	4/754	810	228	30783	7018524								7,018,524	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug	
12	Myzafer Sami Memushi, Myfit Sami Hamataj	1/2, 1/2	8260	4/466	1931	8	30783	246264	293							246,264	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019 të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug	Në seksionin "D" ka shënimin mbi këtë truall ndodhet pasuria nr. 4/379/ND, në favor të Qamile Plakut dhe në seksionin "E" ka shënimin: "Ka 7 ndërtime pa leje. Të kufizohen veprimet deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit"
20	BP Vorpsi, Kika, Lika (Avenir Ali Kika, Sadete Shaban Kika, Lirie Qazim Lika, Vjollca Qazim Vorpsi, Bardhyl Ali Kika, Afërdita Qazim Vorpsi, Alda Kujtim Kika, Flutra Qazim Kika, Klejda Kujtim Kika, Lulëzim Qazim Kika, Sokol Muharrem Kika, Vera Kika, Arjeta Muharrem Dalipi)	24/216, 24/216, 12/216, 12/216, 24/216, 24/216, 12/216, 12/216, 8/216, 12/216, 8/216, 12/216, 24/216, 8/216, 24/216	8260	6/741	762	375	30783	11543625								11,543,625	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019 të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug	
21	Besnik Shyqyri Sinani		8260	6/716	166.34	142	30783	4371186								4,371,186	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019 të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug	Në seksionin "E" ka shënimin: "Blokohet në favor të Pro Credit Bank sh.a. Per shumën 500000 Euro".
22	Edmond Dervishi, Lindita Hasko	1/3, 1/3,	8260	6/697	133	133	30783	4094139	72	143	0	143	101278		14523265	18,617,404	Konfirmohet me shkresën	Ndërtesa është 2-



	(Dervishi), Shpresa Dervishi	1/3																nr. prot. 1099/3, datë 9.7.2019 dhe me shkresën nr. prot. 7954/3, datë 29.10.2019, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug, si edhe me shkresën nr. prot. 10934/1, datë 21.1.2020	katëshe, sipas shkresës nr. prot. 16143/1, datë 21.6.2018, të ZVRPP-së Tiranë (beje legalizimi, e planimetri) rezultoni sipas kati përdhës = 72 m ² sip. kati i parë = 71.4 m ² dhe sip. përgjith. = 143.4 m ² me funksion banesë.
23	Mustafa Alush Gjata		8260	6/699	170	170	30783	5233110	92	213	91.9	121	101278	2747725	12254638	20,235,473		Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019 dhe me shkresën nr. prot. 7954/3, datë 29.10.2019, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug, si edhe nr. prot. 10934/1, datë 21.1.2020	Ndërtesë 2-katëshe me funksion të kombinuar. Kati përdhës = 91.9 m ² , me funksion social ekonomik, kati i parë = 121 m ² funksion banim. Dhe sip. përgjith. = 212.9 m ² .
24	BP Sinani, Merja (Tadje Qazim Sinani, Luçie Gani Merja, Dishir Gani Sinani, Shkëlqim Gani Sinani, Fatos Gani Sinani, Rushan Gani Sinani, Agron Gani Sinani)	1/7, 1/7, 1/7, 1/7, 1/7	8260	6/638/ND					158.90	158.90	0.00	158.90	101278.00	0.00	16093074.20	16,093,074		Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019 dhe me shkresën nr. prot. 7954/3, datë 29.10.2019, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug, si edhe nr. prot. 10934/1, datë 21.1.2020	Në përshkrimin e veçantë të kartelës së pasurisë ka shënimin "Pjesë e kësaj pasurie është pasuria me nr. 6/638/ND+1-1, vol. 56, f. 195. Pasuria është e papasur me certifikatë pronësie". Në seksionin "E" të kartelës së pasurisë ka shënimin: "Kjo ndërtesë nuk ka marrëdhënie të zgjidhura me truallin, ndodhet mbi trojet me nr. 6/742, 6/741 dhe 6/720 ZK 8260".
25	Anife Bilbil Shoraj		8260	6/638/ND+1-1					28.10	28.10	0.00	28.10	101278.00	0.00	2845911.80	2,845,912		Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/3, datë 9.7.2019, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Jug, si dhe me shkresën nr. prot. 7954/3, datë 29.10.2019, si edhe nr. prot. 10934/1, datë 21.1.2020	
26	Eduard Minella Gjini		8260	6/325	372	120	30783	3693960								3,693,960		Konfirmohet me shkresën nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019 të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Në seksionin "E" ka shënimin: "Ka 2 ndërtime pa leje. Të kufizohen veprimet deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit". Në seksionin "D" ka shënimin: "Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. pas. 6/27-ND.
SHUMA			1335.8														89,584,546		

SHËNIM
 1. Pasuritë e prekura nga projekti konfirmohen me shkresat nr. prot. 1099/1, datë 17.6.2019, nr. prot. 1099/3, datë 9.7.2019, nr. prot. 7954/3, datë 29.10.2019, si edhe nr. prot. 10934/1, datë 21.1.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug.
 2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
 3. Për objektet me funksion social-ekonomik, vlerësimi është bërë me metodën e kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet mesatare, sipas zërave të punës për qytetin e Tiranës, të vëna në dispozicionin tonë nga Enti Kombëtar i Banesave, me shkresën me nr. prot. 684, datë 27.3.2018.
 4. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi, vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 2149/4, datë 30.4.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug.

**URDHËR****Nr. 153, date 30.7.2020****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH**

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 1, të nenit 12, dhe të pikës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si edhe të germës “c”, pika 2, të nenit 7, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e pjesshëm të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Ardian Hajdari, si vijon:

- Përfaqëson Kolegjin në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë, por jo kufizuar këto

marrëdhënie në bashkëpunime me institucionet e tjera, organet publike, organizata ndërkombëtare.

2. Delegimi i kompetencës së mësipërme është për periudhën nga data 5.8.2020 deri në datën 15.8.2020.

3. Gjyqtari z. Ardian Hajdari, për periudhën e sipërcituar, do të nënshkruajë në emër të kryetarit në mungesë të tij:

- Shkresat që dalin nga institucioni drejtuar Komisionerit Publik, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, si edhe denoncuesve, lidhur me denoncimet e paraqitura prej tyre pranë Kolegjit, të cilat janë brenda afatit të ankimimit.

4. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Ardian Hajdari.

5. Gjyqtari z. Ardian Hajdari nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Albana Shtylla**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 532 lekë